



**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË**

**RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM**

**Programi i Studimit me Karakter Profesional**

**"Dizajn i Aplikuar dhe Modë"**

**Universiteti European i Tiranës**

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

**Phd. Elvan Dajko**

**Dr. Dorina Arapi**

**Shtator 2021**

**Për Programin e Studimit me Karakter Profesional**

**"Dizajn i Aplikuar dhe Modë"**

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti European (UET)
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Arteve të Aplikuar, njësi bazë në Fakultetin e Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale
3	Emërtimi i programit të studimit:	Dizajn i Aplikuar dhe Modë
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë (UMASR) Nr. 555, datë 11.09.2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Diplomë Profesionale
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Nuk përfshihet në 3 ciklet e arsimit universitar sipas Bolonjës
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vjet
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 5
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	PAE 13/PAK 2
18	Numri i studentëve:	V.A. 2018-2019: 10 të regjistruar V.A. 2019-2020: 33 të regjistruar V.A. 2020-2021: 1 i regjistruar
19	Komente / të tjera:	-

## **PËRMBLEDHJE E TE DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Programi i studimit me karakter profesional në "**Dizajn i Aplikuar dhe Modë**", është hapur me Urdhër të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë (UMASR) Nr. 555, datë 11.09.2018 "**Për hapjen e programit të studimit me karakter profesional në "Dizajn i Aplikuar dhe Mode" në Universitetin Europian të Tiranës**". Në përputhje me pikën 2 të UMASR Nr. 555, datë 11.09.2018, programi i studimit ka filluar veprimtarinë akademike në vitin akademik 2018-2019 dhe është në proces akreditimi për herë të parë. Programi ofrohet nga Departamenti i Arteve të Aplikuara, njësi bazë në Fakultetin e Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale, sipas përcaktimeve të Urdhërit të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 528, datë 04.09.2018, "Per riorganizimin e njësive kryesore "Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Edukimit", në "Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale", në Universitetin Europian të Tiranës".

Programi i studimit përmban 120 kredite (ECTS), zhvillohet në gjuhën shqipe, me kohë të plotë studimi dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike (4 semestra). Në përfundim të ciklit të studimeve lëshohet "Diplomë Profesionale" në "Dizajn i Aplikuar dhe Modë". Objektivi kryesor i këtij programi është formimi i profesionistëve dhe specialistëve në fushën e Dizajnit të Aplikuar dhe Modës.

Ky program synon ti pajisë studentët me njohuri teorike, dhe ato praktiko-aplikative në fushën e dizajnit të aplikuar dhe modës. Në këtë program studentët arrijnë të përftojnë dije profesionale, të cilat lidhen ngushtë me kërkesat e tregut të punës si në kontekstin shqiptar, por dhe më gjerë, duke plotësuar në këtë mënyrë nevojat dhe sfidat e reja në realitetin bashkëkohor të fushës së imazhit, dizajnit dhe modës.



## PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Mbas aplikimit për nisjen e procedurës së akreditimit të programit "Dizajn i Aplikuar dhe Modë", të Universitetit Europian të Tiranës (UET) dhe Urdhërit nga ASCAL për kryerjen e vlerësimit të këtij programi studimi u përcaktuan edhe ekspertët e vlerësimit të jashtëm :

- 1) Phd. Elvan Dajko
- 2) Dr. Dorina Arapi

Fazat e vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit "Dizajn i Aplikuar dhe Modë" janë paraqitur si më poshtë:

Grupi i punës së vlerësimit të jashtëm bëri vlerësimin mbi bazë dokumentacioni të paraqitur nga Institucioni aplikues, Universitetit Europian të Tiranës (UET)

1. Aprovimi i agjendës së vizitës në IAL u bë ndërmjet dy anëtarëve të Grupit të Vlerësimit të jashtëm dhe koordinatores teknike të ASCAL, Arjana Alija;
2. Vizita në institucion u krye në datat 10 dhe 11 qershor 2021, sipas përcaktimit në agjendë. Grupi i vlerësimit të jashtëm realizoi me përpikmëri takimet e caktuara sipas agjendës.

Ditën e parë, më datë 10.06.2021 u realizuan:

- Takimi me Dekanin e Fakultetit të Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale
- Përgjegjës të Departamentit të Arteve të Aplikuara;
- Takimi me Grupin e vetëvlerësimit;
- Takim me Përfaqësues të Komisionit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe zyrës së kurikulave;
- Takim me stafin akademik të angazhuar në këtë program studimi (të brendshëm dhe të jashtëm);
- Takim me përfaqësues të zyrës së projekteve dhe partneriteteve;
- Dhe në fund takimi përmbyllës i ditës së parë.

Ditën e dytë, më datë 11 qershor 2021 u realizuan:

- Takim me përfaqësues të zyrës së burimeve njerëzore;
- Takim me studentët e këtij program studimi;
- Takim me përfaqësues të zyrës së këshillimit të karrierës dhe kujdesit ndaj studentit.
- Vizitë në sekretarinë mësimore
- Vëzhgim i mjediseve (auditorët, laboratorët, dhe shërbimet për studentët etj.) Vizitë në Bibliotekë.
- Takimi përmbyllës me Përgjegjës të Departamentit

3. Hartimi i Draft raportit të vlerësimit të jashtëm dhe dërgimi i tij në Institucion.

Universiteti Europian i Tiranës është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 08.09.2021, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 19/61 Prot, datë 08.09.2021. Universiteti Europian i Tiranës përcjell në ASCAL, me anë të shkresës me Nr. 78/42 Prot, datë 16.09.2021, "Kthim përgjigje mbi draft raportin e vlerësimit të jashtëm", ku konfirmon dakortësinë me vlerësimin e kryer nga ekspertët e jashtëm. Në këtë mënyrë Draft-Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

## Vlerësimi i Programit të Studimit me karakter profesional “Dizajn i Aplikuar dhe Modë”

### I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi me karakter profesional në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij dhe në përputhje me nevojat e kërkesat e tregut të punës.</b>	
Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	<p>Programi ofrohet nga Departamenti i Arteve të Aplikuara, njësi bazë në Fakultetin e Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale", pranë Universitetit Europian të Tiranës". Programi i Studimit “Dizajn i Aplikuar dhe modë” është hartuar në përputhje me misionin dhe qëllimet e Universitetit UET, pas një analizë të detajuar të tregut të punës në Shqipëri, dhe nevojave e sfidave të reja që paraqet sot tregu shqiptar. Programi i studimi synon të krijojë profesionistë me bazë praktike e teknike dhe dije aplikative, që i qaset nevojave të tregut, si dhe të krijojë ekspertë të profilit të dizajnit të aplikuar dhe modës, të cilat janë dy fusha që sot përbëjnë një interes të madh për institucionet publike dhe ato private, në fushën e industrisë kreative. Në vazhden e zgjerimit të tregut të punës për dizajnin dhe modën, ky program studimi plotëson nevojat e tregut të punës e zhvillimit ekonomik në Shqipëri. Në raportin e paraqitur nga institucioni, universiteti ka renditur argumentet për hapjen e këtij programi, si dhe analizën e feedback-un e përftuar nga Bordi i Tregut të Punës. (ref. nr.16; 16.1)</p> <p>Evidenca 2. Statuti i UET</p> <p>Evidenca 3. Plani strategjik 2015-2020</p> <p>Evidenca 3.3 PLANI STRATEGJIK_UET_2021</p> <p>Evidenca 4. Plani strategjik për zhvillimin e programit të studimit - DP Dizajn i Aplikuar dhe Modë</p>
<b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit duhet të përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe të demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	<p>Orientimet prioritar akademike janë të përcaktuara në statutin dhe rregulloren themelore të institucionit. Rregullorja mësimore e programit të studimit me karakter profesional mbështetet në Ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM Nr. 41, dt.24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, në Statutin dhe Rregulloren e Universitetit Europian të Tiranës. Universiteti synon ruajtjen e profilizimit të tij kryesor në shkencat shkencave politike e sociale, arkitekturës, inxhinierive, komunikimit, artet pamore, skenike,</p>

	<p>etj., por diversifikon ofertën akademike dhe në fusha të tjera, si industria kreative, të cilat mbeten një kërkesë e lartë e tregut të punës si në Shqipëri, dhe më gjerë.</p> <p>Evidenca 2. Statuti i UET</p> <p>Evidenca 5. Rregullore e UET</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimeve ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit, si dhe fushën akademike të njësisë kryesore/kolegjit profesional dhe atë të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit.</p>	<p>Ky program studimi me karakter profesional është hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe në fushën e veprimtarisë akademike të universitetit, duke plotësuar ofertën akademike të Fakultetit të Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale, si dhe duke përmbushur nevojat e tregut të punës për profesionistë në fushën e dizajnit dhe industrisë kreative.</p> <p>Evidenca 1. Mendimi i Dekanes DPDAM</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Propozimi, hartimi dhe realizimi i programit të studimit me karakter profesional mbështetet në studime të mirëfillta mbi tregun lokal e kombëtar të punësimit për këto programe.</p>	<p>Për të hapur dhe ndërtuar programin me karakter profesional në “Dizajn i Aplikuar dhe Modë” është bërë studimi i tregut në formën e focus grupeve me Bordin e Tregut të Punës dhe kontaktet me aktorët e tregut të punës, ku janë krijuar ura komunikimi dhe bashkëpunimi midis Universitetit European të Tiranës dhe bizneseve më të mëdha në Shqipëri. Hapja e këtij program vjen si një përgjigje e hapësirave të krijuara të punësimit dhe të vetëpunësimit kundrejt ofertave në tregun e punës, duke përmbushur kërkesën aktuale të tregut të industrisë kreative. Një rol të rëndësishëm për konsolidimin e këtij program, ka dhe Bordi i Tregut të Punës. (ref. nr.12.1)</p> <p>Evidenca 16. Argumentimi për hapjen e programit</p> <p>Evidenca 16.1 Analizë e DAA e tregut të punës para hapjes_Prespektiva punësimi</p> <p>Evidenca 17. Studim Periodik Tregu i Punës - DP Dizajn i Aplikuar dhe Modë</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Gjatë realizimit të programit të studimit, nga pranimit në diplomim dhe pas daljes së studentëve në punë, zhvillohen studime periodike mbi tregun e punës, ndryshimet përkatëse dhe punësimin e studentëve.</p>	<p>Studimi i tregut të punës, vjen dhe nëpërmjet kontakteve që mban universiteti me shoqatën UET ALUMNI, me studentët e diplomuar, gjë e cila jep të dhëna konkrete mbi ecurinë dhe orientimin e të diplomuarve të brezit të parë të studentëve me kërkesat e tregut në këtë fushë.</p> <p>Evidenca 12.4 Takime dhe aktivitete_Bordi iTregut te Punes.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Studimet paraprake dhe periodike të tregut të punës për programet me karakter profesional duhet të përfshijnë të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në</p>	<p>Në hapjen dhe implementimin e këtij programi studimi me një qasje praktike-profesionale të profesionit të dizajnerit dhe atij të modës, universiteti ka realizuar një vëzhgim të tregut të punës, nevojave dhe sfidave të reja, duke patur një feedback nga Bordi i Tregut të Punës. Hulumtimi dhe vëzhgimi, si dhe këshillat e pasqyruara nga ky bord, kanë shërbyer si bazë për ngritjen, hartimin dhe artikullimin e kurrikulës profesionale të këtij program studimi.</p> <p>Bashkëpunimi i Drejtuesit të Departamentit, që është dhe</p>

<p>sektorin përkatës.</p>	<p>përgjegjësi për mbajtjen e marrëdhënieve me Bordin e Tregut të punës, ndihmon në përditësimin e nevojave të tregut, si dhe sfidave të reja që paraqiten, për ti përshtatur e reflektuar ato më pas në praktikën mësimore dhe njohuritë aplikative të studentëve në fushën e dizajnit të aplikuar dhe modës.</p> <p>Kontakti dhe konsultat me përfaqësuesit e bizneseve, shërbimeve e profesioneve të specializuara në fushën e dizajnit dhe modës, të cilët janë pjesë e Bordit të Tregut të punës, e bëjnë më konkrete e të prekshme pjesën e terrenit dhe realitetit të tregut shqiptar, gjë që favorizon ecurinë e zbatimit e praktikave më të mira në fushën e industrisë kreative.</p> <p>Evidenca 18. Adresimi i rekomandimeve të hapjes</p> <p>Evidenca 12.1 Bordi i Tregut të Punës</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Niveli i përmbushjes</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi I.2</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit dhe me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, dhe në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësi respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Ndarja e detyrave dhe përgjegjësi është e përcaktuar në rregulloren dhe në aktet e tjera të brendshme të institucionit. Detyrat dhe përgjegjësitë ndahen midis njësive të ndryshme, ku njësia bazë është përgjegjëse për programin e studimit. Në njësinë bazë, është e përcaktuar qartësisht roli i përgjegjësit të kësaj njësie, përgjegjësit të grup-lëndëve dhe titullarit të lëndëve.</p> <p>Për realizimin e praktikave profesionale, institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, shoqata dhe aktorë të punës, gjë e cila është në funksion të punësimit të studentëve, duke ndjekur politikat e nevojat e tregut të punës në Shqipëri. Studentët i zhvillojnë praktikën profesionale në semestrin e dytë të vitit të dytë, gjë e cila ndiqet më pas nga mbrojtja e diplomës.</p> <p>Përmirësimi i praktikave profesionale dhe efektivitetit të tyre në funksion të realizimit të programit akademik, vlerësohen nga një komision i posaçëm dhe nga studentët, ku nëpërmjet një formulari, arrihet të merret një feedback mbi këto praktika dhe mundësitë për ti përmirësuar ato në funksion të përmbushjes së njohjeve teorike -praktike në fushën e dizajnit të aplikuar dhe modës.</p>

	<p>Evidence 6. Dokumenti F.IV-F.V Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit</p> <p>Evidenca 38. Analiza e departamentit përgjegjës</p> <p>Evidenca 35. Raporti analitik i perfitimeve nga marreveshjet e bashkepunimit</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave të procesit mësimor, formimin teorik e praktik të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie afatgjata e të qëndrueshme bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, me punëdhënës vendës, aktorë të biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Ky program studimi me formim të përgjithshëm artistik, dhe aplikativ, i jep mundësinë studentëve për të hyrë në tregun e punës, në fushën e dizajnit grafik, dekorimin e interierit e dizajnin e modës. Duke patur në fokus këshillat e Bordit të tregut të punës, nëpërmjet konsultave dhe analizave të hollësishme të tregut, ky program studimi synon të harmonizojë dijet teorike me ato aplikative, në mënyrë që studentët të jenë të përgatitur profesionalisht nevojat, sfidat dhe potencialet që ofron tregu aktual shqiptar.</p> <p>Institucioni ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione të tjera homologe brenda vendit dhe jashtë vendit, me aktorë të biznesit vendas të huaj, si dhe për kryerjen e marrëveshjeve bashkëpunimi institucionale. Kjo gjë bazohet në hartimin e strategjisë së ndërkombëtarizimit, ku përfshihet dhe programi i studimit të diplomës profesionale Dizajn i Aplikuar dhe Modë. Programi Erasmus+, u lejon studentëve dhe stafit akademik të kryejnë mobilitete në Universitete të tjera jashtë vendit. Nga diskutimi me Zyrën e Projekteve rezulton se shkëmbimi është i hapur dhe për studentët e këtij programi por për shkak të pandemisë shkëmbimet priten të realizohen në muajt në vazhdim.</p> <p>Evidenca 34.10 MEMORANDUM BASHKEPUNIMI MES UET DHE CREATEUR STUDIO</p> <p>Evidenca 34.11 MEMORANDUM BASHKEPUNIMI MES UET DHE CREISS PETROVIQ</p> <p>Evidenca 34.12 MEMORANDUM BASHKEPUNIMI MES UET DHE OnOff</p> <p>Evidenca 34.8 Akt Marreveshje Bashkepunimi mes UET dhe Tirana Desing Academy, Nr.75. Prot, date 30.04.2021</p> <p>Evidence 34.8 MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI - UET &amp; Instituti i Modës KAÇELI</p> <p>Evidence 34.9 Marreveshje Bashkepunimi mes UET dhe Universitetit te Arteve Nr. 185.Prot, date 12.07.2018</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të perfitimeve nga marreveshjet e bashkëpunimit në funksion të</p>	<p>Në fund të çdo viti akademik, në UET praktikat vleresohen nga një komision i posaçëm dhe nga vetë studentët me anë të një formulari ku merret një feedback për efektshmërinë e realizimit të tyre, gjë e cila ndihmon në përmirësimin e mëtejshëm të</p>



realizimit të programeve të studimeve.	praktikave profesionale.			
	Evidenca 35. Raporti analitik i perfitimeve nga marreveshjet e bashkepunimit			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.	Përveç parashikimeve në marreveshjet e bashkëpunimit apo në marrëdhëniet me institucionet ku studentët kryejnë praktikën, procedurat e zhvillimit të praktikave profesionale janë të rregulluara edhe nëpërmjet akteve të brendshme, në të cilat janë parashikuar si procedurat që duhet të ndiqen ashtu edhe roli i aktorëve dhe njësive të ndryshme të përfshira në këtë proces.			
	Evidenca 32.1 Dokumenti B.I Mbi praktikën profesionale			
	Evidenca 32.2 B-I-4 Formulari i vetëvleresimit te praktikës (nga Studenti)			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni ndërmerr iniciativa specifike në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve.	Institucioni ndërmerr iniciativa specifike në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve. Por përgjatë muajve të pandemisë, universiteti nuk ka mundur të ofrojë trajnime specifike për studentët, në këtë aspekt.			
	Evidenca 29. Tabelë përmbledhëse per punësimin real të studenteve_Aneks Tabela 23 DPDAM			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi I.3</b>	
<b>Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi dhe Kuadrin Evropian e Shqiptar të Kualifikimeve për këto programe studimi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programet e studimeve janë të organizuara në lëndë/module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi është i organizuar në lëndë dhe module (11 në vitin e pare dhe 10 në vitin e dytë ku përfshihen dhe “Praktikë dhe zhvillim student” dhe “Provim formimi/Projekt profesional”), të vlerësuara në kredite në përputhje me udhëzimet e MASR, konform legjislacionit në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve. Lëndët janë të vlerësuara me 4 deri në 6 ECTS (2 me 4 ECTS, 1 me 5 ECTS dhe të tjerat me 6 ECTS). Në total, ky program studimi 2 vjecar përmban 120 ECTS.  Evidenca 14. Kurrikula e programit DP Dizajn i Aplikuar dhe Mode (Kurrikula e programit të studimit, me ndarjen dhe peshën e kategorive të veprimtarive formuese të miratuar me UMASR Nr. 555, datë 11.09.2018)
<b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve me karakter profesional synojnë përfitim të njohurive gjithë përfshirëse të specializuara	Programi i studimit me karakter profesional në “Dizajn i Aplikuar dhe Modë” nxit ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave

<p>teorike dhe praktike brenda një fushe punësimi në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>akademike e kulturore kombëtare. Ky program synon për edukimin dhe formim akademik, duke kombinuar njohuritë me teknikat, proceset e parimet estetike të procesit krijues të dizajnit të aplikuar dhe të modës. Program i studimit përputhet me strategjinë e zhvillimit të institucionit, duke plotësuar ofertën akademike të Fakultetit të Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale. Programi i studimit i përcjell studentit njohuri të përgjithshme si dhe njohuri praktike të cilat mund të aplikohen në industrinë kreative, duke gërshetuar dhe lëndë teorike të cilat plotësojnë figurën e profesionistit në fushën e kësaj industrie, që kombinohen në këto profesione në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.</p> <p>Evidenca 4. Plani strategjik për zhvillimin e programit të studimit - DP Dizajn i Aplikuar dhe Modë</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit me karakter profesional synojnë pajisjen e studentëve me një sërë aftësish njohëse dhe praktike gjithëpërfshirëse që nevojiten për të zgjidhur në mënyrë krijuese probleme të karakterit profesional praktik.</p>	<p>Programi i studimit pajis studentët me aftësi njohëse të përgjithshme dhe praktike gjithëpërfshirëse që formësojnë studentin për të elaboruar ide kreative dhe të jenë të aplikueshme në fushën e modës dhe dizajnit.</p> <p>Plani mësimor sipas veprimtarive formuese (Ref. Nr. 14.2)</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit me karakter profesional synojnë zhvillimin e kompetencave për menaxhimin dhe mbikëqyrje në kuadrin e veprimtarive profesionale dhe orientimin e duhur në situata të ndryshme e të ndryshueshme.</p>	<p>Programi zhvillon aftësitë individuale-krijuese dhe aplikative, si dhe ato komunikuese e bashkëpunuese. Personeli akademik kryen dhe këshillim studentet, tutoriat si dhe veprimtari të tjera, që janë në shërbim të ecurisë së programit e ecurisë së tij. (ref. A.V. Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik, A.V.1) Ngarkesa e plotë mësimore për personelin akademik është në përputhje me përcaktimet ligjore.</p> <p>A - DISIPLINA TË FORMIMIT TË PËRGJITHSHËM (BAZË)/ 15-20%/21 ECTS/ 4 lëndë Shkrim Akademik Hyrje në Sociologji Hyrje në psikologji Estetikë</p> <p>B - DISIPLINA TË FORMIMIT KARAKTERIZUES TË PROGRAMIT 40 - 50%/ 58 ECTS/ 10 lëndë Bazat e dizajnit për modën Vizatim Bazat e grafikës Bazat e multimedias Bazat e artit konceptual Fotografi Ngjyra dhe Drita Histori Arti Tipografi dhe faqosje</p> <p>C - LËNDË NDËRDISIPLINORE/INTEGRUESE/ 15 - 20%/ 18 ECTS</p>

	<p>Dizajn i brendshëm Dizajn dhe modë 1: Hyrje në dizajnin e tekstilit Dizajn dhe modë 2: Dizajn aksesorësh dhe bizhuterish</p> <p>D - LËNDË PLOTËSUESE/ 10% - 20%/ 15 ECTS Anglisht Bazat e informatikës Praktikë dhe zhvillim karriere</p> <p>E - DETYRIME PËRMBYLLËSE/ 3% - 5%/ 6 ECTS Provim formimi/Projekt profesional</p> <p>Evidenca 12. Dokumenti E-VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit</p> <p>Evidenca 10. Dokumenti B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit</p> <p>Evidenca 27.2. Dokumenti A.V. Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni/njësia kryesore/kolegji profesional dhe njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë të organizimit, strukturës akademike dhe numrit e shkallës së kualifikimit të stafit akademik.</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie ka kualifikimin e ciklit pasardhës. Personeli akademik ka status të veçantë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, si edhe në aktet rregullatore të universitetit. Thirrjet për stafin akademik janë publike dhe ndjekin rregullat e kriteret e paracaktuara. Bazuar në të dhënat tabelore të vëna në dispozicion, rezulton se stafi akademik i njësive bazë përbehet nga 17 PAE, nga të cilët:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 3 me titullin akademik Prof. Dr.;</li> <li>- 2 me titullin akademik Prof. As. Dr.;</li> <li>- 2 me gradë shkencore "Doktor";</li> <li>- 10 asistentë lektorë me kualifikimin "Master i Shkencave".</li> </ul> <p>Personeli akademik me kontratë (PAK) pranë njësive bazë, janë 11, nga të cilët:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 2 me titull akademik Prof. Dr.;</li> <li>- 1 me gradë shkencore "Doktor";</li> <li>- 1 në PhD në process</li> <li>- 7 asistentë lektorë me kualifikimin "Master i Shkencave".</li> </ul> <p>Mund të thuhet që përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë të organizimit, strukturës akademike dhe numrit e shkallës së kualifikimit të stafit akademik.</p> <p>Evidenca 23. Të dhëna tabelore për personelin akademik të fakultetit dhe departamentit_DAA (Aneks_Tabela 1dhe 2)</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin profesional të studentëve, ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të</p>	<p>Programi i ka të përcaktuara objektivat për formimin profesional të studentëve. Studentët në këtë program marrin njohuri të përgjithshme teorike e artistike, duke u fokusuar në dy drejtime: dizajn me orientim grafik dhe dizajni i modës.</p>

programit të studimit dhe që e karakterizojnë profilin profesional të programit.	Evidenca 7. Rregullore_ DP Dizajn i Aplikuar dhe Mode. Rregullore e programit të studimit DP Dizajn i Aplikuar dhe Modë, pika 3.3 dhe Aneks 1.  Evidenca 4. Plani strategjik për zhvillimin e programit të studimit - DP Dizajn i Aplikuar dhe Modë			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

## II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

<b>Standardi II.1</b>	
<b>Programet e studimeve me karakter profesional janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të këtij niveli dhe mundësitë e punësimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit me karakter profesional, përmbajnë dhe japin informacionet e nevojshme për objektivat formues, rezultatet e pritshme të të nxënëit, organizimin, strukturën, përmbajtjen, fushat e mundshme të punësimit apo të dhëna reale të punësimit të studentëve të diplomuar në këto programe.	Rregullorja e programit ka përcaktuar informacionet që i nevojiten studentëve për sa i përket objektivave, rezultatet e pritshme të të nxënëit, organizimin dhe fushat ku mund të punësohet studenti pas diplomimit. Në rregulloren e programit jepen dhe synimet/afësisimet kryesore si :  1. Njohuri dhe koncepte bazë të fushës së studimit 2. Aftësi drejt një profesioni apo licence profesionale 3. Formim qytetar të përgjithshëm 4. Aftësi bazë për punë kërkimore 5. Aftësi të përgjithshme praktike, aplikative 6. Aftësim për promovim personal 7. Projekt profesional pa origjinalitet kërkimor por që dëshmon si është kuptuar puna e studiuesve të tjerë në fushën përkatëse.  Struktura e programit është e konceptuar për ti përcjellë studentit njohuri të përgjithshme formuese në këto fusha:

Struktura e programit të studimit të grupuara në 5 kategori, nga A – ja deri te E– ja.

- i) Kategoria A: Lëndë bazë- përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme
- ii) Kategoria B: Lëndë karakterizuese – përgatitje për disiplinën shkencore
- iii) Kategoria C: Lëndë ndërdisiplinore/integruese – grupe disiplinash, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje.
- iv) Kategoria D: Lëndë plotësuese –gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale.
- v) Kategoria E: Detyrime përmbyllëse –punimi i diplomës ose provim i përgjithshëm formues.

Hapësirat e punësimit të studentëve që diplomohen në këtë program janë:

- a) Stilist/ fashion dizajner
- b) Grafist
- c) Dekorues interieri

Shtirirja e këtyre profesioneve shtrihet dhe prek institucione tw ndryshme publike apo private të cilat punojnë në fushat e industrisë kreative dhe ato artistike.

Të detajuara janë informacionet në programet e secilës lëndë ku përmbahen: kodin e lëndës, emërtimi i lëndës, pedagogu që udhëheq dhe firmën e tij, ngarkesën (numrin e krediteve), llojin e lëndës, programin e studimit ku ofrohet lënda, semestrin dhe vitin akademik kur zhvillohet lënda, adresën elektronike të pedagogut udhëheqës dhe firmën për konsultim e syllabusit të përgjegjësit të grup-lëndëve dhe firmën e miratimit të përgjegjësit të departamentit.

Në programin e lëndës janë të shënuara:

- Përmbledhja dhe rezultatet e të nxënit.
- Konceptet themelore mbi të cilat ndërtohet lënda.
- Temat e kursit dhe metodologjia që përdoret në seminarin e radhës.
- Literatura e detyrueshme dhe e rekomanduar për çdo temë
- Format e kontrollit të dijeve.

Sipas të dhënave, studentë të diplomuar për periudhën 2019-2020 janë:

Numri total të diplomuarve – 4 studentë ku:

Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)- 3 studentë

Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën) – 1 studentë

	<p>Evidenca 7. Rregullore_ DP Dizajn i Aplikuar dhe Modë  Evidenca 14. Kurrikula e programit  Evidenca 19. Syllabuset e programit</p> <p>Evidenca 29. Tabelë përmbledhëse për punësimin real të studenteve_ Aneks Tabela 23 DPDAM (Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve (Tabela 23)</p> <p>Evidenca 0 RVB_ DP Dizajn i Aplikuar dhe Modë</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimit janë të organizuara në module/lëndë e aktivitete formuese, të vlerësuara me kredite, të ndara në vite e semestra e që janë në përputhje me përcaktimet vendëse e evropiane në fuqi.</p>	<p>Lëndët janë të vlerësuara me nga 4 deri në 6 kredite (ECTS), e me një total kreditesh 120 ECTS në dy vite program studimi.</p> <p>Në syllabus përfshihet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• përmbajtja e njohurive</li> <li>• metoda pedagogjike</li> <li>• bibliografia e detyruar dhe të rekomanduar</li> <li>• kontrolli i njohurive</li> </ul> <p>Syllabuset pasqyrojnë të gjithë informacionet e nevojshme për lëndën dhe janë të konsulturara nga përgjegjësi i grup-lëndëve dhe më pas miratohen nga përgjegjësi i departamentit. Kjo praktikë ndihmon në mos mbivendosjen e temave dhe lëndëve të programit të studimit. Planet mësimore janë hartuar sipas kuadrit ligjor në fuqi. Gjithashtu kurrikula plotëson kriterin e balancimit të përmbajtjes teorike me atë praktike.</p> <p>Në rregulloren e programit janë të përcaktuara qartë, vlerësimi në bazë kreditesh për çdo lëndë. Kreditet e çdo lënde mbajnë parasysh ngarkesën në orë mësimore në auditor, si dhe punën individuale që duhet kryer nga studenti për përmbushjen e të gjitha detyrimeve të parashikuara në programin e lëndës. Lëndët e thjeshta kanë 4 - 6 kredite, ndërsa ato të përbëra nga module kanë 10 - 12 kredite. Një kredit është 25 orë mësimore pune e studentit, përbërë nga orë mësimore për transmetim dijesh në auditor (leksione, seminare, ushtrime, projekt/detyra, dhe veprimtari të tjera formuese brenda lëndës) dhe orë për punë të pavarur të studentit.</p> <p>Evidenca Evidenca 7. Rregullore_ DP Dizajn i Aplikuar dhe Modë ( ref. Pika 4. Kreditet)  Evidenca 14. Kurrikula e programit DP Dizajn i Aplikuar dhe Modë  Evidenca 39. Dokumenti A.III Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ndjekjen e programit, vlerësimin e dijeve, aktivitete specifike etj.</p>	<p>Programi i lëndës shpjegon përmbajtjen e kursit, si dhe detyrimet që duhet të përmbushë studenti përgjatë kursit. Në të shpjegohen format e zhvillimit të procesit mësimor ku përmban:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>a. Leksioni është shpjegimi i lëndës mësimore nga pedagogu</li> <li>b. Seminari që nxit dhe stimulon aktivizimin e studentëve.</li> <li>c. Leksion/seminari proces i kombinuar i leksionit dhe i seminarit.</li> <li>d. Puna laboratorike që shërben në vlerësimin e aftësive të studentëve nëpërmjet veprimtarive praktike dhe laboratorike në atelier.</li> </ol>

- e. Praktika mësimore ku studenti aplikon njohuritë teorike të marra në auditor, dhe i aplikon ato.
- f. Detyrat praktike
- g. Detyra kursi.
- h. Provimet e ndërmjetme/përfundimtare janë format kryesore të vlerësimit të studentëve.
- i. Praktika profesionale që është detyrim akademik që synon të lidhë njohuritë teorike dhe praktike të fituara gjatë studimeve me profesionin/et përkatës/e dhe t'i familjarizojë studentët me tregun e punës, e cila është dhe e detyrueshme për të mbrojtur më pas diplomë.
- j. Punimi i diplomës/Provimi i Përgjithshëm Përfundimtar është detyrimi përfundimtar i studentit për marrjen e diplomës në përfundim të programit të studimit.

Struktura e programit e lëndës për programin me karakter profesional “Dizajn i Aplikuar dhe Modë” përmban rubrikat si më poshtë:

Informacion të përgjithshëm, ku pasqyrohen: emërtimi i lëndës, emri i pedagogut të lëndës, firma, ngarkesa (numri i krediteve, numri i orëve mësimore në klasë), tipologjia e lëndës, semestrin kur zhvillohet lënda, llojin e lëndës (e detyrueshme ose opsionale), programin e studimit ku ofrohet kjo lëndë, kodin e lëndës, adresën elektronike të pedagogut të lëndës dhe emrin e Drejtuesit të Departamentit përkatës.

Në programin e lëndës pasqyrohen përmbledhja dhe qëllimet e kursit, synimet që kursi synon të arrijë; Konceptet themelore e terma bazë mbi të cilat ndërtohet lënda; Temat e leksionit ku paraqitet jepet shpjegimi i hollësishëm i çdo teme të leksionit të ndara sipas javëve, e cila shoqërohet me literaturën përkatëse. Në këtë seksion paraqiten dhe metodat e format pedagogjike që ndihmojnë në procesin e seminarit përkatës; Format e kontrollit të dijeve janë format e vlerësimit të studentëve, të shprehura si përqindje e notës përfundimtare, siç janë niveli i diskutimit në seminare, provimi i ndërmjetëm, detyra e kursit, detyrat praktike dhe provimi përfundimtar., etj; Literatura e detyrueshme dhe fakultative.

Kurrikula dhe pesha e aktiviteteve formuese është miratuar me hapjen e programit.

Frekuentimi i procesit mësimor (leksione, leksion/seminar, seminare) është i detyrueshëm në masën 60% (gjashtëdhjetë). Frekuentimi i orëve laborator dhe praktika mësimore është i detyrueshëm në masën 100% (njëqind).

Evidenca 53.1 VKM Nr. 41\_datë 24.01.2018\_Elementët e programeve të studimit

Evidenca 39. Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës (A.III. Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës dhe të përdorimit të

	<p>literaturës)</p> <p>Evidenca 14. Kurrikula e programit DP Dizajn i Aplikuar dhe Modë</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit përmbajnë syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikatat, ushtrimet apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët e aktivitetet formuese të programit të studimit.</p>	<p>Në bazë të vizitës pranë universitetit rezulton se plotësohet kriteri i balancimit të përmbajtjes praktike-teorike të programit. Në këtë program studimi me karakter profesional, frekuentimi i procesit mësimor është i detyrueshëm në masën 60%, kurse frekuentimi i orëve në laborator dhe praktika mësimore, është i detyrueshëm në masën 100%.</p> <p>Evidenca Evidenca Evidenca 7. Rregullore_ DP Dizajn i Aplikuar dhe Modë ( ref. Pika 6. Frekuentimi)</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Struktura dhe organizimi i programit të studimit është mjaftueshmërisht fleksibël për të mundësuar formimin e studentëve përgjatë programit dhe në përshtatje me punësimin.</p>	<p>Pavarësisht se struktura dhe organizimi i programit të studimit Dizajn i Aplikuar dhe Modë, synon të formësojë formimin e studentëve, në përshtatje me punësimin dhe me kërkesat e tregut të punës e fushave të industrisë kreative, dhe që vjen si një rezultat i reflektimeve të kryera dhe të marra nga Bordi i Tregut të Punës, që ky universitet ka ngritur, ndërtimi dhe artikulumimi i një programi, që është dhe mbetet i domoshdoshëm për kontekstin shqiptar, duhet të rishikohet përsa i përket syllabuseve të disa lëndëve, të cilat do të jepnin një input të domoshdoshëm për formimin e studentit në këto profesione.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Mësimi praktik dhe i elementeve të punës konkrete u është dhënë vendi dhe pesha e duhur në strukturë, vlerësim dhe rivlerësim.</p>	<p>Mësimi praktik dhe i elementeve të punës konkrete u është dhënë vendi dhe pesha e duhur në strukturë, vlerësim dhe rivlerësim.</p> <p>Sipas rregullores së programit, praktika profesionale për studentët e programeve me karakter profesional ka 5 ose 6 ECTS; pra një detyrim prej 125-150 orë punë, për studentin. Nga këto, 28 orë zhvillohen në auditor (4 seanca nga 2 orë), mbi njohuri të përgjithshme të zhvillimit profesional dhe të karrierës që bëhen nga pedagogu Këshillues i karrierës dhe (10 seanca nga 2 orë) me ekspertë të fushës, 72 ose 92 orë në institucion dhe 25 ose 30 orë punë individuale, në varësi të numrit të krediteve të praktikës.</p> <p>Procesi i zhvillimit të praktikës është i rregulluar sipas kriterëve të paracaktuara në rregullore.</p> <p>Raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formuese.</p> <p>Evidenca 32.1 Dokumenti B.I Mbi praktikën profesionale (B.I. Mbi praktikën profesionale)</p> <p>Evidenca 38. Analiza e departamentit përgjegjës (B. Programi akademik)</p>



Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi II.2	
<p><b>Struktura, plani mësimor dhe shpërndarja lëndore e programeve të studimit me karakter profesional, është në përputhje me objektivat formuese, rezultateve të të nxënit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve dhe kërkesave të tregut të punës për këto programe.</b></p>	
Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Emërtimi, struktura dhe shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore është në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>Elementët e programit të studimit, emërtimi i lëndëve, struktura e vitit akademik, ndarja në orë e kredite dhe Rregullorja mësimore e programit të studimit me karakter profesional është në përputhje me parashikimet ligjore të nenit 70 të Ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM Nr. 41, dt. 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, në Statutin dhe Rregulloren e Universitetit European të Tiranës.</p> <p>Përpara hapjes dhe licensimit të këtij programi studimi universiteti ka realizuar një vëzhgim të tregut të punës, nevojave dhe sfidave të reja, duke patur një feedback nga Bordi i Tregut të Punës, si dhe janë zhvilluar konsulta me pedagogë për ndërtimin e kurrikulës. Hulumtimi dhe vëzhgimi, si dhe këshillat e ofruara kanë shërbyer si bazë për ngritjen, hartimin dhe artikullimin e kurrikulës profesionale të këtij program studimi.</p> <p><i>Referuar dokumentacionit të paraqitur nga institucioni, sugjerojmë që në bordin e tregut të punës të jenë anëtarë më shumë artistë, dizajner dhe stilistë, të cilët do të jepnin një feedback më të plotë për këtë program studimi.</i></p> <p><i>Pavarësisht kësaj, grupi i vlerësimit të jashtëm, sugjeron që disa lëndë të kenë ndryshime në programin e tyre, duke e fokusuar më së tepërmi në dizajn dhe modë. Dicka më vlerë për këtë program, do të ishte që lëndë, si historia e artit, estetika, psikologjia dhe sociologjia, të kishin në fokus të programit të syllabusit, tema të cilat trajtojnë dhe lidhen me modën dhe dizajnin, si histori dizajni, histori e modës, psikologjia e konsumatorit, sociologji e modës. Bota e dizajnit është e shtrirë dhe e segmentuar në mjaft fusha, sepse çdo aspekt i jetës së konsumatorit, sidomos sot, është i ndikuar prej tij. Këto do të ndihmonin akoma më shumë në orientimin akademik të studentëve, duke bërë më konkrete analizën dhe interpretimin</i></p>

	<p><i>artistik ndaj këtyre fushave.</i></p> <p>Evidenca 7. Rregullore_ DP Dizajn i Aplikuar dhe Modë</p> <p>Evidenca 13. Dokumenti E.VIII Mbi funksionimin e Zyrës së Kurrikulave</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, struktura dhe shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit, rezultateve të pritshme të të nxënësve dhe punësimin e studentëve.</p>	<p>Veprimtaria mësimore shtrihet në 2 (dy) semestra me kohëzgjatje 14 javë. Ky program studimi me karakter profesionale përmban 120 ECTS, ku ngarkesa vjetore është 60 ECTS, e ndare me 30 ECTS çdo semester, duke ndjekur rregullon e planit mësimor.</p> <p>Evidenca 7. Rregullore_ DP Dizajn i Aplikuar dhe Modë</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Plani mësimor, natyra dhe emërtimi i moduleve/lëndëve, syllabusët e moduleve e të aktiviteteve formuese janë informuese dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara.</p>	<p>Programi i studimit, plani mësimor, disiplinat mësimore dhe veprimtaritë formuese, si dhe kreditet rishikohen në mënyrë periodike, në përputhje me parashikimet në aktet nënligjore dhe aktet rregullatore të universitetit. Ndryshimet propozohen nga Departamenti, Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave, por edhe nga anëtarë të personelit akademik, e cila kryhet në konsultim me Bordin e Tregut të Punës. Ndryshimet e propozuara shqyrtohen në departament, si dhe nga Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave dhe më pas dërgohet për miratim në mbledhjen e Dekanatit.</p> <p>Evidenca 13. Dokumenti E.VIII Mbi funksionimin e Zyrës së Kurrikulave</p> <p>Evidenca 37. Formati i relacionit për monitorimin e silabuseve</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Ka një raport të balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik përkundërt atyre praktike (50:50). Rreth 25% e programit i dedikohet aftësimin në praktikë/punë konkrete në profesion.</p>	<p>VKM nr.41 datë 24.01.2018 e ndryshuar me VKM nr. 879 datë 18.12.2019, parashikon se duhet të ketë një raport të balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik kundërt atyre praktik, si dhe 25% të programit duhet t'i dedikohet aftësimin në profesion.</p> <p>Nga materialet e vëna në dispozicion, rezultojnë se raporti i formimit teorik përkundërt atij praktik, 55:45 dhe bazuar tipologjisë së aktivitetit në auditor (orëve) 54:46 duke qënë kështu në një balancë të mirë përderisa favorizohet gjithsesi aspekti praktik në sintoni me natyrën e programit. Mosndarja në mënyrë të saktë 50/50 justifikohet nga institucioni me faktin që gjatë licensimit nuk ishte në fuqi kjo kërkesë. Rekomandohet në çdo rast balancimi i plotë.</p> <p>Gjithashtu, programi i dedikohet rreth 25% aftësimin praktik/punë konkrete në profesion.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Klasifikimi sipas aktiviteteve formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave</p>	<p>Programi i studimit është hartuar në përputhje me objektivat formues dhe nevojat e tregut të punës. Klasifikimi sipas aktiviteteve formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe</p>

formues dhe orientimin e studentit drejt studimeve të mëtejshme dhe/ ose në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues dhe orientimin e studentit drejt studimeve të mëtejshme dhe/ ose në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.			
	Evidenca 19. Syllabuset e lëndëve			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

<b>Standardi II.3</b>	
<b>Përmbajtja e lëndëve, moduleve dhe formave të tjera formuese të programeve të studimit me karakter profesional është në përputhje me objektivat formuese, rezultatet e të nxënit dhe kërkesat e tregut të punës për këto programe</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit përmban të dhëna të plota mbi përmbajtjen e moduleve/lëndëve të formimit teorik e praktik dhe aktiviteve të tjera të formimit sipas strukturës e planit të studimit.	<p>Programi i studimit përmban të dhëna të plota mbi përmbajtjen e moduleve/lëndëve të formimit teorik e praktik dhe aktiviteve të tjera të formimit sipas strukturës e planit të studimit.</p> <p>Në rregulloren mësimore, në strukturën e programit të studimit (3.1.1) Veprimtaritë formuese grupohen në 5 kategori, nga A – ja deri te E – ja.</p> <p>Kategoria A: Lëndë bazë- përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme</p> <p>Kategoria B: Lëndë karakterizuese – përgatitje për disiplinën shkencore</p> <p>Kategoria C: Lëndë ndërdisiplinore/integruese – grupe disiplinash, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje.</p> <p>Kategoria D: Lëndë plotësuese – gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale.</p> <p>Kategoria E: Detyrime përmbyllëse – punimi i diplomës ose provim i përgjithshëm formues.</p> <p>Programi i studimit ndjek politikat institucionale të universitetit, në lidhje dhe sipas standartit të syllabuseve. Pedagogu i lëndës është ërgjegjës për hartimin e syllabusit. duke ndjekur statutin, përpara fillimi të vitit akademik, plani mësimor konsultohet dhe me Bordin e Tregut të Punës. Çdo syllabus përfshin dhe pasqyron të gjitha kriteret, rregullat e nevojshme për zhvillimin e lëndës. (Ref. nr. 19.)</p> <p>Evidenca 7. Rregullore_ DP Dizajn i Aplikuar dhe Mode 3. PROGRAMI I STUDIMIT 3.1 Struktura e programit të studimit</p>
<b>Kriteri 2.</b> Përmbajtja e programit të studimit është aktuale, i plotëson kërkesat e veçanta të	Programi hartuar synon ti pajisë studentët me njohuri teorike,

<p>profesionit dhe kërkesat për aftësitë shprehite e kërkuara/të pritshme nga punëdhënësit.</p>	<p>dhe ato praktiko-aplikative në fushën e dizajnit të aplikuar dhe modës. Në këtë program studentët arrijnë të përftojnë dije profesionale të përgjithshme, të cilat lidhen ngushtë me kërkesat e tregut të punës si në kontekstin shqiptar, por dhe më gjerë, duke plotësuar në këtë mënyrë nevojat dhe sfidat e reja në realitetin bashkëkohor të fushë së imazhit, dizajnit dhe modës.</p> <p>Për përmirësimin dhe thellimin e njohurive në fushën e dizajnit të aplikuar dhe modës, disa lëndë mund të kenë rishikime në programin e tyre, duke patur në fokus të programit të syllabusit, tema të cilat trajtojnë dhe lidhen drejtpërdrejtë e specifikisht me studimin e analizën e marrëdhënies së konsumatorit, terrenit me modën dhe dizajnin, për të kuptuar fenomenet artistike, që mund të shërbejnë si “formula” të nevojshme për t’u interpretuar dhe zbatuar në të tashmen dhe të ardhmen.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Përmbajtja parashikon zhvillimin e aftësive të transferueshme, e shtrirë edhe në modulet e përmbajtjen e tyre, gjatë zhvillimit të kurrikulës dhe në metodat e mësimdhënies dhe vlerësimit.</p>	<p>Përmbajtja e kurrikulës dhe metodat e mësimdhënies synon zhvillimin e aftësive të transferueshme në fushën e modës dhe dizajnit. I gjithë programi i këtij kursi është i ndërtuar, duke konsideruar aftësitë dhe kompetencat që duhet të ketë një profesionist i dizajnit dhe modës, me qëllim që të kryej me profesionalizëm detyrat që i ngarkohen. Dijet profesionale të përgjithshme, që studentët përftojnë në këtë program studimi, i mundëson atyre implementimin e njohurive praktike dhe teknike në fushën e dizajnit dhe të modës.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Modulet dhe aktivitetet e formimit teorik e praktik/punë konkrete mundësojnë përfitim të njohurive, aftësive dhe shkathtësive ndërkurrikulare, të menduarit kritik, zgjidhjen e problemeve në kontekste konkrete, komunikimin dhe marrëdhëniet me të tjerë, si dhe orientimin cilësor në përvojën e punës.</p>	<p>Formimit praktik, i punës konkrete dhe praktikave profesionale në vecanti, i mundëson studentëve aksesin në tregun e punës dhe kërkesat që paraqiten në realitetin shqiptar në këto fusha profesionale. Një përshtatje dhe një adaptim më i plotë me kërkesat e tregut dhe një orientim cilësor në përvojën e punës, do të ishte dhe bashkëveprimi e ndërveprimi me artizanët shqiptar dhe gërshetimin e shprehive artistike bashkëkohore, gjë që institucioni e aplikon në disa lëndë, si ato që kanë të bëjnë me modën e tekstilin, dhe që është e pasqyruar në planin strategjik. Kjo do të ndikonte dhe në mundësitë e punësimit dhe të kualifikimit profesional.</p> <p>Evidenca 4. Plani strategjik për zhvillimin e programit të studimit - DP Dizajn i Aplikuar dhe Modë</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Bashkëpunimi me punëdhënësit, internship-i/përvoja praktike, tutorazhi, e vlerësimi i tyre në profesion është e mjaftueshme, e përshtatshme dhe garanton formimin praktik në përputhje me kërkesat e profesionit.</p>	<p>Procedurat e zhvillimit të praktikave profesionale janë të rregulluara edhe nëpërmjet akteve të brendshme, ku përfshihen jo vetëm procedurat që duhet të ndiqen, por dhe roli i aktorëve dhe njësive të përfshira në këtë proces. Praktikat profesionale zhvillohen në bashkëpunim me institucioneve apo shoqata, me të cilët universiteti ka vendosur lidhje bashkëpunimi, gjë që është pasqyruar dhe në planin e vizionin strategjik të</p>

	universitetit. Evidenca 4. Plani strategjik per zhvillimin e programit te studimit - DP Dizajn i Aplikuar dhe Modë Evidenca 32. Lista e subjekteve bashkëpunuese për programin dhe praktikat profesionale_DAA Evidenca 35. Raporti analitik i perfitimeve nga marreveshjet e bashkepunimit			
<b>Shkalla e përmbushjes së standartit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

#### Standardi III.1

**Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional përmes politikave e udhëzimeve të posaçme dhe mbështetet në metodat dhe praktikat më të mira të fushës**


Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues të posaçëm, ngre struktura të posaçme dhe zhvillon mekanizma të vlerësimit e të monitorimit të cilësisë së mësimdhënies dhe metodave të përdorura dhe aftësive të stafit të angazhuar, duke përfshirë aktivisht studentët në këtë proces. Rezultatet e këtyre vlerësimeve bëhen publike.	Bazuar në “Neni 11-Sigurimi i brendshëm dhe i jashtëm i cilësisë” të Statutit (Ref. Nr 2 e DVB), institucioni harton udhëzues të posaçëm, ngre struktura të posaçme dhe zhvillon mekanizma të vlerësimit e të monitorimit të cilësisë së mësimdhënies dhe metodave të përdorura, në vecanti njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë e cila duhet te jetë garant për vlerësimin periodic të cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit si dhe raportimin në organet përkatëse.  Në fakt Njësia/Komisioni e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë, e përbërë nga 11 antarë (Tab. 24 e Ref. Nr. 30 dhe Ref. Nr. 30.4 e DVB), si një nga Komisionet e përhershme të institucionit, ka një rol të mirëpërcaktuar si në statut (Ref. Nr 2 e DVB) (Neni 16, Neni 19.7 pika 4c) ashtu dhe në Rregulloren e UET ((Ref. Nr. 5 e DVB) Neni 6.1 pika 2 b), duke pasur dhe rregullore të posaçme si “F.VII. Mbi Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë” (Ref. Nr. 8 e DVB), Plani veprimit KSBC (Ref. Nr. 30.1 e DVB), “Manuali per Sigurimin e Brendshem te Cilesise” (Ref. Nr. 30.2 e DVB) dhe strategji si “Strategjia per Sigurimin e Brendshem te Cilesise_2017-2022” (Ref. Nr. 30.3

e DVB), etj. UET ka qënë pjesëmarrës dhe në dy projekte ndërkombëtare me focus pikërisht Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (Ref. Nr. 30.9 dhe 30.10 e DVB).

Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies dhe metodave të përdorura dhe aftësive të stafit të angazhuar, duke përfshirë aktivisht studentët në këtë process, bëhet me disa mënyra (Rregullore Mësimore e UET, Neni 22-Vlerësimi i procesit mësimor), më konkretisht:

- Çdo student ka mundësinë e vlerësimit në mënyrë anonime për çdo lëndë/pedagog në fund të çdo semestri ((Ref. Nr. 5 e DVB) Rregullore UET, Neni 22.2 - Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies së personelit akademik). Ky vlerësim bëhet me anë të formularit “G.III.4.2/ FORMULAR VLERËSIMI I STUDENTËVE PËR PEDAGOGUN DHE LËNDËN” (Ref. Nr. 40 e DVB) ku shikohet mundësia e vlerësimit të një sërë pikash si mësimdhënia, vlerësimi dhe sqarimi, këshillimi akademik dhe një hapësirë e lirë për komente qoftë për gjera positive dhe negative. Vlerësimi zhvillohet online nëpërmjet platformës online LMS dhe rezultatet përpunohen dhe shpërndahen pedagogëve dhe drejtuesve.
- Vlerësimi i mësimdhënies së pedagogut në auditor nga një staf i autoriteteve drejtuese ose i përgjegjësit të Departamentit, ose nga kolegë apo ekspert i jashtëm. Ky vlerësim bëhet duke qënë i pranishëm gjatë procesit mësimor dhe duke plotësuar formularin “G.III.4.1 / FORMULAR PËR VLERËSIMIN E PEDAGOGUT” (Ref. Nr. 30.8 e DVB) në të cilin mund të vlerësohen një sërë pikash mbi organizimin dhe qartësinë e lëndës, komunikimin me studentët dhe duke shkruar mbi merita të pedagogut apo sugjerime.
- Çdo dy vjet stafi akademik duhet të plotësojë një formular vetëvlerësimi, “G.I.12/1 FORMULAR I VETËVLERËSIMIT TË PERFORMANCËS SË PERSONELIT AKADEMIK” (Ref. Nr. 41 e DVB). Në të kërkohet një raportim i gjërë mbi procesin e mësimdhënies dhe lëndët që merr pjesë, procesin e kërkimit, publikimet, projektet ku ka marr pjesë, objektivat e ardhshme, etj.

Të gjitha rezultatet i nënshtrohen një përpunimi, vlerësimin periodik raportimin në organet përkatëse nga ana e KBSC-së. Raportet përvec vlerësimit të drejtpërdrejtë të pedagogëve/lëndëve, përfshijnë dhe vlerësime nga KBSC, bazuar në një metodologji të mirëpërcaktuar (Ref. Nr. 30.5 e DVB), në lidhje me organizimin e provimeve (Ref. Nr. 30.6 e



	<p>DVB), kontrolle të syllabuseve (Ref. Nr. 30.7 dhe 37 e DVB) dhe ndërtimit të lëndëve (për të pare konformitetin me legjislacionin në fuqi dhe rregulloren “A.III. Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës dhe të përdorimit të literaturës” (Ref. Nr. 39 e DVB)), etj.</p> <p>Raportet i vihen në dispozicion pedagogëve përkatës dhe drejtuesve, ku këto të fundit mund të ngrejnë dhe komisione për <i>follow up</i>.</p> <p>Instrumente të tjeta për marrjen e informacioneve apo sugjerimeve për përmirësimin e mësimdhënies është dhe organizimi i <i>focus grupeve</i> me studentët, pjesëmarrja në mbledhjet e hapura të departamentit (të referuar si një here në muaj në RVB) ku studentët mund të shprehin opinionet dhe mendimet e tyre, takimet me bordet e punës për të pare dhe raportimin e njohurive me kërkesat e tregut, monitorimi i bërjes së procesit mësoimor nga sekretaria, kontrollet e përmbajtjes së lëndëve nga përgjegjësi i grup-lëndëve, Keshilli i Etikës ((Neni 19.6 i Statutit (Ref. Nr 2 e DVB)) i cili merret me çështje të etikës në mësimdhënie dhe kërkim, etj.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra e kursit/eseja, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni e që është e përshtatshme për realizimin e programit të studimit.</p>	<p>Në rregulloret e institucionit (Ref. Nr. 39 e DVB), konkretisht pika A.III.3. -Format e zhvillimit të procesit mësimor e “A.III. Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës dhe të përdorimit të literaturës”, shprehet qartë që format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive në UET janë leksione, seminarë, leksion/seminare, punë laboratorike, praktika mësimore, detyra praktike, detyra kursi, provime të ndërmjetme, provime përfundimtare, praktika profesionale dhe me punim diplome.</p> <p>Në Planin mësimor për Programin e studimit me karakter profesional në “Dizajn i Aplikuar dhe Modë” (Ref. Nr. 14.1 e plotësimeve të kërkuara në DVB) shikohet që format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve janë leksione, seminarë, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale të zhvilluara në auditor (Ese/Detyra e kursit, Praktika Mësimore), provime të ndërmjetme, provime përfundimtare, praktika profesionale dhe me punim diplome.</p> <p>Ndërkohë që leksione dhe seminarët zhvillohen përgjatë gjithë kohëzgjatjes së lëndëve (14 jave per semester, (Ref. Nr. 10.1-10.3 e DVB), praktika profesionale zhvillohet gjatë semestrit të dytë të vitit të fundit. Kontrolli i dijeve me anë të detyrave apo provimeve është i vazhdueshëm në menyrë që studentet të kenë mundësi të përgatiten gradualisht si dhe të vlerësojnë mangësitë personale përpara provimeve apo dorëzimeve finale. Referuar informacioneve të përcjella GVJ dhe raporteve, përgjatë zhvillimit të programit organizohen dhe</p>

	<p>leksione të hapura apo vizita studimore të lidhura me fushën e studimit (Ref. Nr. 4, 12.4 dhe 38 e DVB).</p> <p>Duke parë programin mësimor (Ref. Nr. 14.1-14.3 e plotësimeve të kërkuara në DVB) dhe shqyrtimin e syllabuseve (Ref. Nr. 19 e DVB), gjykohet që format e mësimdhënies dhe mësimnxënies janë të përshtatshme për realizimin e programit të studimit.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik përdor forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, në përgjigje dhe të diversitetit dhe nevojave të studentëve.</p>	<p>Institucioni ka udhëzues përsa i përket mënyrës së ndërtimit të lëndës, “A.III. Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës dhe të përdorimit të literaturës” (Ref. Nr. 39 e DVB), në të cilën parashikohen dhe metodat kryesore të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Megjithatë, pedagogët në kuadër të lirisë së tyre kanë mundësi në varësi të lëndës të integrojnë forma dhe metoda alternative. Syllabuset e secilës lënde (Ref. Nr. 19 e DVB) që i vihen në dispozicion studentëve që para fillimit të vitit, përmbajnë, konceptet themelore dhe temat që trajtohen, metodat pedagogjike, format e kontrollit/vlerësimit të dijes, literature e detyruar, literature e rekomanduar, etj. Vetë tipologjia e programit përfshin ato më të konsoliduara si me leksione “<i>ex-catedra</i>” e deri te forma më alternative si prezantimet, ekspozitat, vizita studimore, etj. Në përgjithësi, duke parë dhe natyrën e profilit, mbetet thelbësore modeli i studio/atelier në të cilën studentët praktikohen nën ndjekjen dhe udhëzimet e pedagogëve. Metoda të tjera, referuar dhe në RVB dhe nga takimi me pedagogët dhe studentët, janë diskutimet dhe puna në grup, analiza e rasteve studimore, organizimi i diskutimeve që nxisin mendimin kritik, etj., duke siguruar kështu një ndërveprim dhe përfshirje të gjithë studentëve pa cënuar individualitetin dhe vecantinë e gjithësecilit.</p> <p>Nga vizita në institucion u vërejt dhe mundësia e përdorimit të teknologjive VR e cila me integrimin në program mund të sjell rezultate shumë positive. Natyrisht ekzistojnë dhe mënyra e forma të tjera si focus grupe, world café, etj të cilat mund të sjellin rezultate interesante në procesin e mësimdhënies e mësimnxënies por gjykojmë që metodat që përdoren aktualisht janë konform tipologjisë së programit.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies, përfshirë ato interaktive e gjithëpërfshirëse, sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i CV (Ref. Nr. 20 e DVB) të vëna në dispozicion mund të thuhet që personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie (Ref. Nr. 2. “DP Dizajn dhe mode_Plani mesimor me stafin akademik” i plotësimeve të kërkuara nga DVB) është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve të lidhura me programin, madje mund të thuhet mbi një pjesë që janë personazhe të spikatura në këtë fushë me një balance të mire përvoja akademike me atë profesionale. Më lart u shpjegua përdorimi i metodave të ndryshme që</p>



	<p>përdoren dhe ku sqarohej që për shkak jo vetëm të karakterit profesional të programit por dhe specialitetit të vecantë, një pjesë e madhe e mësimdhënies është e mirëqënë që është interaktive dhe gjithëpërfshirëse. I referohemi metodologjisë së punës në atelier, realizimi i prezantimeve dhe ekspozitave në grup, etj., të cilat janë “<i>by default</i>” metoda që kërkojnë e nxisin ndërveprimin.</p> <p>Ne zhvillimin e lëndëve në auditor përdoren gjithashtu mjete ndihmëse dixhitale, kompjuteri, projektori, etj. Gjithashtu prezantimet dhe bërja e leksioneve online me anë të dy platformave online UET-LMS dhe TEAMS për shkak të pandemisë (Ref. Nr. 5.2 dhe 5.3 e DVB) duke shfrytëzuar dhe mënyrat online të komunikimit që parashikojnë platformat, si forumet apo <i>chat-et</i>, kanë bërë të mundur vijimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies, ku pavarësisht mundësisë së ndërveprimit, ka nxjerr në pak vecorinë për këto programe të bërjes mësim në salla duke garantuar një ndërveprim akoma më të ngushtë sic është dhe vetë natyra e programit dhe që numri jo shumë i madh i studentëve mundëson.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të mbështesë stafin përmes njohjes me shembujt e praktikave të mira, të nxisë dhe të inkurajojë personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Në bazë të raporteve (sipas RVB dhe Ref. Nr. 35 te DVB), rezulton se UET organizon trajnime të personelit akademik me vëmendje dhe ndaj aspekteve të mësimdhënies në mënyrë që të nxiten përdorimi i metodave inovative të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Gjithashtu, duke marr për të mirëqënë që kërkimi shkencor ka një ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e kapaciteteve të stafit dhe cilësinë e mësimdhënies, trajnimet, shkëmbimet dhe nxitja/stimulimi për kërkimin shkencor dhe publikimet ndikojnë pozitivisht në këtë drejtim.</p> <p>Pjesëmarrja në projekte shkëmbimi/rritje kapacitetesh gjithashtu ka një ndikim shumë pozitiv në përmirësimin e mësimdhënies. Në nja nga projektet e raportuara nga Zyra e projekteve, konkretisht “ConSus”, vërehet që fokusi ka qënë pikërisht në nxitjen dhe trajnimin e stafit dhe në integrimin e metodave bashkohore ku bashkarisht me partnerët janë zhvilluar dhe janë publike dhe të aksesueshme një sasi e madhe metodash të cilat mund të merren si praktika të mira dhe të integrohen në proceset mësimore.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>



**Standardi III.2**


Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike të nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor teorik e praktik, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p>	<p>Mjediset mësimore si klasat, labororet, studio/atelier-et dhe mjediset e tjera janë të pajisura me mjetet dhe pajisjet e duhura për të garantuar funksionalitetin dhe cilësinë e mësimdhënies në to. Hapësirat janë të bollshme, të kondicionuara dhe të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit (Ref. Nr. 42 e DVB dhe vizita e GVJ).</p> <p>Klasat për leksione dhe seminare janë të pajisura me mjete audio dhe vizive si PC, projektorë dhe foni.</p> <p>Labororët e informatikës janë pajisura me <i>softwaret</i> përkatës për të mundësuar mësimdhënien dhe praktikën e dizenjimit dixhital. Në një nga labororët u vërejtën dhe pajisje me teknologji VR (syze dhe <i>soft-et</i> përkatëse) të cilat mund të mundësojnë metoda inovatore si të mësimdhënies ashtu dhe të mësimnxënies.</p> <p>Praktikat mësimore të studentëve të lidhura drejtpërdrejtë me lëndë specifike të programit, të cilat mund të realizohen nën ndjekjen e pedagogëve përgjegjës në Laboratorin e Arteve Pamore dhe Dizajnit, një hapësirë shumëfunktionale me një sipërfaqe rreth 250m<sup>2</sup>, e pajisur me mjete bazë për punë praktike të studentëve të programit.</p> <p>Në shërbim të programit, vecantërisht për aktivitete prezantuese dhe ekspozimi, janë dhe hapësira të tjera si:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>-Salla Aula Magna me një sipërfaqe afër 200 m<sup>2</sup>, e pajisur me një post të konceptuar për regjinë dhe produksionin audio e video.</li><li>- Laboratori i Arteve Skenike – me një sipërfaqe afër 250m<sup>2</sup></li><li>-Holli i Godinës A të UET</li></ul> <p>Përveç hapësirave nën menaxhimin e drejtpërdrejtë të institucionit, studentët mund të shfrytëzojnë për praktikë, falë marrëveshjeve me UET dhe në mënyrë të koordinuar dhe hapësira të tjera si:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Tirana Design Academy, një hapësirë si entitet më vete juridik dhe ekonomik por “brenda kampusit” të UET e cila mundëson dhe praktikën e studentëve të programit Programit të Studimit me karakter profesional në “Dizajn i Aplikuar dhe Modë”.</li></ul> <p>Për studentët e programit “Dizajn i Aplikuar dhe Modë” janë në dispozicion 3 salla për zhvillimin sa më të mirë të lëndëve</p>



	<p>praktike si vizatim, pikturë, dhe dizajn.</p> <p>Pavarësisht kësaj, në sugjerim mbetet në vëmendje përmirësimi i klasave të laboratorëve të lëndëve aplikative dhe artistike, të cilat duhet të pajisen me mjetet e nevojshme që i nevojiten një laborator. Rasti për shembull i laboratorit të grafikës, duhet të të pajiset me aparatura, të cilat ndihmojnë e lehtësojnë punën e studentëve dhe pedagogëve. Laboratori i grafikës duhet të jetë pajisur me ventilatorë të atillë në mënyrë që të pastrojnë ajrin nga lëndët që përdoren për grafikën e shtypur. Laboratori duhet të pajiset me mjete dhe aparatura (lavamanë dhe tavolina të gjera), për ecurinë e funksionin sa më të mirë të lëndës.</p> <p>-Mjediset e institucioneve me të cilat janë lidhur marrëveshje bashkëpunimi me qëllim bërjen e praktikave profesionale. Institucioni ka dorëzuar një listë me 14 institucione/sipermarrje/organizata (Ref. Nr. 32 dhe 34.1-34.12 e DVB).</p> <p>Përvec këtyre hapësirave, studimi mundësohet dhe në ambjentet e bibliotekës e cila ka 150 vende leximi dhe rreth 15 PC për konsultime online apo kases në platforma dhe abonime dixhitale.</p> <p>Ambjentet universitare janë të mbuluara nga sinjali Wi-fi nga ku stafi dhe studentët mund të aksesojnë në web-in apo në platformt e UET, si LMS, TEAMS, etj. (Tabela 17 e Ref. Nr. 0.2 e DVB), duke bërë të mundur ndjekjen e leksioneve online apo përditësimin me informacione dhe materialet/ leksione të pedagogëve, vlerësimet, etj.</p> <p>Në përgjithësi mund të thuhet që hapësirat mësimore janë të mjaftueshme dhe cilësore, funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor, si dhe sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.</p>	<p>Institucioni ka ngritur një sistem të brendshëm të menaxhimit të informacionit duke garantuar jo vetëm një arkivim dhe përpunim të të dhënave kryesore por dhe shfrytëzimin e tij për realizimin e procesit mësimor, komunikimit të brendshëm dhe akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar për stafin akademik dhe studentët.</p> <p>Kjo arrihet përmes instrumentave dhe platformave të mëposhtme:</p> <p>a. UMS-University Management System (Ref. Nr. 46 dhe 46.1 e DVB), shërben si instrument për ruajtjen, administrimit dhe përpunimin e informacioneve që kanë të bëjnë me aspekte të menaxhimit të institucionit, të programeve të studimit dhe të studentëve. Aksesit është i mundur nga stafi</p>

	<p>administrative përkatës duke përfshirë dhe mundësi në seksione enkas dhe për stafin akademik.</p> <p>b. Platforma UET LMS-Learning Management System (Ref. Nr. 46.1-46.4 e DVB), e vendosur në funksionim që 2016, e cila funksionon si nje database ku gjenden të pasqyruara: literatura për çdo lëndë e materiale audio/video; Njoftimet e pedagogut për çdo lëndë dhe për çdo grup; Pikët individuale nga pedagogu për çdo student dhe çdo vlerësim; Kalendar për studentin dhe pedagogun; Dërgimi i detyrave/eseve nga studentët; Mundësi komunikimi mes studentëve dhe pedagogëve; orare, Lista e notave të studentit, informacione të tjera në lidhje me universitetin, etj.</p> <p>c. Për shkak të pandemisë së virusit COVID-19, universiteti ka vendosur në përdorim dhe platformën Microsoft TEAMS (Ref. Nr. 46.4 e DVB), që ka shërbyer për të realizuar mësimin interaktiv, në distancë. Nëpërmjet kësaj platforme janë realizuar gjithashtu dhe seancat metodologjike për udhëheqjen e studentëve diplomantë.</p> <p>d. E-mail, ku çdo staf akademik, administrativ dhe student furnizohet me një e-mail personal me ane të cilave mund të shkëmbehet informacion zyrtar.</p> <p>Keto menyrë/platforma komunikimi, arkivimi, informimi, shkëmbimi dhe mësimdhënie janë lehtësisht të aksesueshme si nga ambientet e UET ashtu dhe nga ambientet personale të studentëve dhe stafit nëpërmjet internetit.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve literaturë bazë dhe ndihmëse, në formë fizike dhe elektronike, gjë e cila pasqyrohet si në bibliotekën e universitetit, po ashtu dhe online (Ref. Nr. 45 e DVB).</p> <p>Institucioni ka një sërë sistemesh, duke nisur nga përgjegjësi i grup lëndëve, drejtuesit dhe KBSC të cilat garantojnë kontrollin për përputhshmërinë e literaturës me objektivat e lëndëve si dhe garantimin e aksesimit të saj në fondin fizik apo dixhital të bibliotekës.</p> <p>Institucioni përkujdeset gjithashtu që në bazë të kërkesave për shtimin e literaturës (Ref. Nr. 45.1- 45.3 e DVB), të pasurojë fondin e bibliotekës në mënyrë që të garantohet cilësia e marrjes dhe përditësimin e njohurive të domosdoshme.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe</p>	<p>Biblioteka e UET, bazuar RVB dhe vizites, është pjesë e sistemit COBISS (Sistemi dhe shërbimet e perbashketa</p>



<p>studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>bibliografike online), një rrjet ku perfishihen vende të rajonit të Evropës Juglindore, duke perfaqesuar një model organizativ të lidhjes së bibliotekave në sistemin kombëtar të informacionit bibliotekar me katalogim të përbashket.</p> <p>Biblioteka e UET lejon një akses të lirë dhe pa pagesë për stafin dhe studentët si dhe është e pajisur me pc dhe me mbulim wi-fi duke garantuar kështu dhe aksesin në arkivat/fondin e literatures në formë dixhitale si dhe të platformave online (Tabela 17 e Ref. Nr. 0.2 e DVB) ku ka abonimet si:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Sage&amp;EBSCO</li> <li>2. Questia</li> <li>3. ASTM Compass</li> <li>4. Edëard Elgar Publishing – Elgar Online Platform</li> </ol>
<p><b>Kriteri 5.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Mjediset mësimore si klasat, labororet, studio/<i>atelier</i>-et dhe mjediset e tjera janë të pajisura me mjetet dhe pajisjet e duhura për realizimin e detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike (Ref. Nr. 42 e DVB dhe vizita e GVJ). Ato përdoren brënda kohëve të kalendarit të caktuar nga institucioni si dhe në mënyrë të vecantë studentët e Programit të studimit me karakter profesional në “Dizajn i Aplikuar dhe Modë” kanë hapësira të dedikuara si Laboratorin e Arteve Pamore dhe Dizajnit, një hapësirë shumëfunktionale me një sipërfaqe rreth 250m<sup>2</sup>, apo Tirana Design Academy, të pajisura me mjete bazë për punë praktike të studentëve apo përpunimin e diplomës.</p> <p>Prezenca e tyre te kjo e fundit u verifikua dhe gjatë vizitës në institucion.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik i UET përdor platformën online UET-LMS si dhe gjatë fazes së leksioneve online për shkak të pandemisë edhe platformen Microsoft Teams (Ref. Nr. 46.1-46.4 e DVB).</p> <p>Bazuar në materialet e dorëzuara, për nxitjen e përdorimit të platformës LMS ka dhe një Urdhër Administrativ, nr. 09, date 02/11/2017 "Mbi zbatimin e plate ne procesin mesimor administrativ te platformes UET LMS"(Ref. Nr. 46.1 e DVB), ku në kuadër të dixhitalizimit të të gjithë procesit të mësimdhënies dhe menaxhimit të informacionit, urdhërohet vendosja në efencë të plotë të platformes LMS (iniciuar në 2016). Platforma UET LMS-Learning Management System (Ref. Nr. 46.2-46.4 e DVB), shërben si një databazë personale për çdo student nga mund te aksesohet në çdo informacion si programi, syllabuset, leksionet, notat dhe kreditet, oraret, etj., por duke funksionuar njëherazi dhe si platformë shkëmbimi</p>

	për dorëzimin e puneve, forum komunikim, shkëmbim mesazhesh, njoftime specifike e të përgjithshme, etj. Staf akademik ka gjithashtu akses për lëndët që është pjesëmarrës nga ku mund të menaxhojë literaturën e lëndëve përkatëse, caktimin e detyrave të kursit, depozitimin e leksioneve, vlerësimet, forume diskutimi online me studentët, etj.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi III.3</b>	
<b>Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat garantojnë cilësinë e mësimdhënies dhe mësimxënies në programet e studimit dhe rritjen e vetëdijes për përmirësimin e tyre</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që ndjekin, vlerësojnë dhe monitorojnë procesin e mësimdhënies dhe koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së saj.	<p>UET ka të ngritur në nivel institucional një sistem për vlerësimin dhe monitorimin e procesit të mësimdhënies si dhe koordinimin dhe bashkërendimin me njësitë kryesore/bazë të aktiviteteve në kuadër të përmirësimit të cilësisë së tij (Ref. Nr. 30 dhe 30.1-30.10 e DVB). Referuar rregullores “F.VII. Mbi Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë” (Ref. Nr. 8 e DVB), strukturat përgjegjëse për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (pika F.VII.5.) janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Strukturat hierarkike organizative (organet drejtuese dhe autoritetet) të UET-it;</li> <li>2. Zyra e Standardeve dhe Cilësisë, e cila kujdeset për hartimin, përditësimin dhe rishikimin e kuadrit rregullator të institucionit dhe procedurave, në përputhje me legjislacionin në fuqi, standardet e cilësisë dhe praktikat e mira kombëtare dhe ndërkombëtare, si edhe monitoron zbatueshmërinë e tyre nga strukturat dhe personeli i institucionit.</li> <li>3. Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë – KSBC, nëpërmjet vlerësimit të efikasitetit të veprimtarive që ushtrohen në UET, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.</li> </ol> <p>Komisioni e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë, si një nga Komisionet e përhershme të institucionit, ka një rol të mirëpërcaktuar si në statut (Ref. Nr 2 e DVB, Neni 16, Neni 19.7 pika 4ci Statutit) ashtu dhe në Rregulloren mësimore ((Ref. Nr. 5 e DVB) Neni 6.1 pika 2 b). Komisioni përbëhet nga Kryetari i Komisionit, një</p>

	<p>përfaqësues nga pedagogët e çdo Fakulteti, një përfaqësues nga personeli ndihmës akademik, ose administrativ, një përfaqësues nga Këshilli i Studentëve, si dhe të paktën një përfaqësues ekspert i jashtëm. Anëtarët propozohen nga Rektori dhe miratohen nga Senati i Akademik.</p> <p>Komisioni vlerëson periodikisht veprimtarinë mësimore, kërkimore ose artistike, si dhe efikasitetin e veprimtarive administrative dhe financiare të institucionit. Secili anëtar i KSBC përgatit raportin e vlerësimit për veprimtarinë e monitoruar. Raporti Përmbledhës i Vlerësimit përgatitet nga Kryetari i KSBC-së ose anëtarë të deleguar prej tij dhe rezultatet publikohen përmes një raporti të brendshëm që i dërgohet Rektorit dhe Administratorit të UET.</p> <p>Pjesët e raportit që lidhen me Fakultetet përkatëse i vihen në dispozicion edhe Dekanëve të Fakulteteve dhe Drejtuesve të Departamenteve. Në këtë mënyrë sigurohet një koordinim dhe bashkërendim me njësitë kryesore/bazë të aktiviteteve në kuadër të përmirësimit të cilësisë së programeve dhe mësimdhënies.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për procesin e mësimdhënies, cilësinë e saj dhe rritjen e vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Bazuar në Statutin e UET ((Ref. Nr 2 e DVB) Neni 15-Njësitë bazë), Departamenti është njësia bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore të Fakultetit, duke qënë njëherazi dhe përgjegjës për programet e studimit që ofron. Në rastin e Programit të studimit me karakter profesional në “Dizajn i Aplikuar dhe Modë”, njësia bazë përgjegjëse është Departamenti i Arteve të Aplikuara.</p> <p>Në dokumentin/rregulloren “F.V. Mbi organizimin dhe funksionimin e Departamentit” (Ref. Nr. 6 e DVB) jepet një informacion shterrues mbi përgjegjësitë të Departamentit dhe Drejtuesit të tij. Sic mund të shihet qartë në të, Departamenti është njësia bazë që përgjigjet për cilësinë e programeve të studimit që mbulon. Ai përgjigjet për formulimin e profileve, si dhe të përmbajtjeve lëndore të programeve.</p> <p>Departamenti është iniciues i procesit të rekrutimit pasi ky process në përgjithësi nis në përputhje me nevojat për personel akademik, bazuar në planet mësimore që zhvillohen në kuadrin e çdo Fakulteti/Departamenti, si dhe ngarkesat mësimore të miratuara ku për shpërndarjen optimale të tyre është përsëri përgjegjës Departamenti. Në këtë mënyrë garantohet që mësimdhënia të zhvillohet nga personel me ekspertizë dhe kualifikimin e nevojshëm por duke garantuar dhe vendosjen e stafit në kushte optimale pune.</p> <p>Departamenti harton sillabuset, kalendaret, caktimin e</p>

	<p>pedagogut përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të praktikave profesionale, shpërndan e mbledh formularët aplikimin dhe vlerësimin, miraton institucionet e praktikave, etj.</p> <p>Departamenti është gjithashtu përgjegjës për monitorimin e procesit të mësimdhënies, vlerësimin të stafit (Ref. Nr. 30.8 e DVB), ngjitjen e komisioneve të posacme për ndjekjen e problematikave, kërkesave për rivlerësime, marrjen e inputeve gjatë mbledhjeve të hapura, rakordimi me zyrat e kurrikulave për përmirësimet e programeve, etj.</p> <p>Nëpërmjet drejtuesit, në bashkëpunim me anëtarë të tjerë të departamentit apo organe të tjera të institucionit, kujdeset për përmbajtjen e programeve të studimit, miraton dhe ndjek zbatimin e planit strategjik për zhvillimin e programeve të studimit, harton përmbajtjen e formularit për zgjedhjen e lëndëve nga studentët, përgatit matricën për hartimin e orarit për lëndët, miraton programet/syllabuset e lëndëve, përgjigjet për hartimin e listës së pyetjeve dhe të tezës së provimit për Provimin e Përgjithshëm Përfundimtar, miraton, në fillim të çdo viti akademik, listën e trajnimeve profesionale që do të zhvillojë departamenti në kuadër të formimit të vazhduar, etj.</p> <p>Departamentet hartojnë në mënyrë periodike raporte dhe vlerësime (Ref. Nr. 39 e DVB).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja, në përputhje me natyrën dhe specifikën e programeve profesionale.</p>	<p>Personeli akademik ka një rol themelor në zbatimin e programeve të studimit. Institucioni ka udhëzues përsa i përket mënyrës së ndërtimit të lëndës, “A.III. Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës dhe të përdorimit të literaturës” (Ref. Nr. 39 e DVB), megjithatë, pedagogët në kuadër të lirisë së tyre akademike rolin kryesor në organizimin e lëndëve dhe bërjen e syllabuset (Ref. Nr. 19 e DVB) ku permbajnë përmbledhjen dhe qëllimin e lëndës, konceptet themelore dhe temat që trajtohen, metodat pedagogjike, format e kontrollit/vlerësimin të dijes, literature e detyruar, literature e rekomanduar, etj.</p> <p>Duke parë jo vetëm karakterin profesional të programit por dhe specialitetin e vecantë, një pjesë e madhe e mësimdhënies merret për e mirëqënë që është interaktive dhe gjithëpërfshirëse pasi metodologjia e punës në <i>atelier</i>, realizimi i prezantimeve dhe ekspozitave në grup, etj, janë “<i>by default</i>” metoda që kërkojnë e nxisin ndërveprimin.</p> <p>Nga diskutimi me stafin akademik perceptohet një angazhim, dedikim dhe një pasion shumë i mire. Gjithashtu studentët konfirmojnë angazhimin korrekt të</p>



	<p>stafit dhe mbështetjen që i jepet atyre. Përveç metodologjive të konsoliduara, shikohet dhe forma më alternative si prezantimet, ekspozitat, vizita studimore, diskutimet dhe puna në grup, analiza e rasteve studimore, organizimi i diskutimeve që nxisin mendimin kritik, etj.</p> <p>Me anë të sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, garantohej një monitorim dhe vlerësim periodik i stafit, ku falë procesit të vlerësimit nga studentët, eprorët/kolegët, vetëvlerësimit, etj, mund të merren inpute të rëndësishme për përmirësimin jo vetëm të përmbajtjes së lëndëve apo programit në tërësi por dhe të metodave pedagogjike të përdorura.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies përmes trajnimeve të vazhdueshme të personelit akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të tyre.</p>	<p>Në RVB deklarohet se UET organizon trajnime të personelit akademik me fokus në aspektet e mësimdhënies në mënyrë që të nxiten përdorimi i metodave inovative të mësimdhënies dhe mësimnxënies.</p> <p>Pjesëmarrja në projekte shkëmbimi/rritje kapacitetesh, referuar nga zyra e projekteve gjatë vizitës, gjithashtu ka një ndikim shumë pozitiv në përmirësimin e metodave të mësimdhënies duke u njohur me praktikat më të mira nga institucionet partnere apo siguruar “<i>on the job trainings</i>”.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e prishmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Sic u përmend dhe më lart, pedagogët kanë për detyrë të deklarojnë paraprakisht, në syllabuset e lëndëve që drejtojnë, metodat pedagogjike që do përdoren (Ref. Nr. 19 e DVB). E thënë kjo, kanë lirinë e tyre të gjykojnë ato më të përshtatshmet, natyrisht duke garantuar plotësimin e qëllimeve dhe objektivave të lëndës. Vecantia e profilit lyp përdorimin e metodave që shkojnë përtej atyre tradicionale, ose më mire më të përhapura, dhe sic jemi shprehur dhe më parë shpesh shikohet integrimi i prezantimeve, ekspozitave, vizitave studimore, diskutimet dhe puna në grup, analiza e rasteve studimore, organizimi i diskutimeve që nxisin mendimin kritik, etj.</p> <p>Stafi ka mundësinë që në fund të çdo lënde të analizojnë dhe raportojë në silabusin e tij efektet dhe rezultatet e metodave si dhe të diskutojë/shpërhapë me studentët dhe kolegët gjatë <i>focus group</i>-eve apo mbledhjeve të hapura të departamentit.</p> <p>Jo më pak i rëndësishëm është dhe monitorimi dhe vlerësimi që i bëhet procesit të mësimdhënies ku fale përgjegjësit të grup lëndëve, vlerësuesve apo KBSC mund të evidetohen praktika të mira e të shpërndahen me tej me kolegët e tjerë të stafit akademik.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Asnjë përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>

				X
--	--	--	--	---


#### Standardi III.4

**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme për vlerësimin e njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën për çdo student.**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimin të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, të cilat bëhen publike. Institucioni mban dhe ruan dokumentacionin e vlerësimeve, ankimimet dhe rishqyrtimet e vlerësimin, sipas afateve e procedurave në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimin të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen qartë në një sërë rregulloresh të institucionit dhe bëhen publike (Ref. Nr. 7.1 dhe 7.2 e DVB). Statuti i UET shprehet qartë (Ref. Nr 2 e DVB, Neni 10) për detyrimin e ndjekjes së standarteve dhe legjislacionit në fuqi nga MASR si dhe bërjes publike të çdo info-je për programet e studimit. Rregullorja e UET (Ref. Nr. 5 e DVB) në KREU V-KONTROLLI DHE VLERËSIMI I DIJES, përmban norma dhe parashikime të nevojshme për kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimin.</p> <p>Rregullorja Mësimore e Programit të Studimit me karakter profesional në “Dizajn i Aplikua dhe Modë” (Ref. Nr. 7 e DVB) përmban informacion të gjerë e të qartë në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimin të dijeve e aftësive të studentëve (5. KONTROLLI I DIJEVE TË FITUARA NGA STUDENTËT) ku përfshihet sistemi i vlerësimin (pika 5.1), mënyra e kontrollit dhe vlerësimin të dijes (pika 5.2), provimet (pika 5.3), riprovimet dhe bartja (pika 5.4), përmirësimet (pika 5.5), etj.</p> <p>Syllabuset (Ref. Nr. 19 e DVB) e secilës lënde, përmbajnë gjithashtu një informacion të detajuar për çdo lëndë lidhur me kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimin të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale.</p> <p>Të gjitha këto informacione janë publike si dhe i jepen çdo studenti përpara fillimit të programit të studimit (ose lëndën në rastet e silabuseve), ku vec të tjerash të gjitha materialet janë të arritshme në çfarëdo momenti në platformat online të UET si LMS apo në webin e UET.</p> <p>Institucioni mban dhe ruan dokumentacionin e vlerësimeve, ankimimet dhe rishqyrtimet e vlerësimin, sipas afateve e procedurave në rregulloret përkatëse. Këto informacione gjenden në trajtë të dyfishtë, atë dixhitale në systemin e brendshëm të menaxhimit të informacionit (UET UMS, UET LMS) ashtu dhe ne kopje fizike në</p>

	Sekretaritetë (Ref. Nr. 9 e DVB) apo arkivat.
<b>Kriteri 2.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	<p>Elemente kryesore të kontrollit të vazhdueshëm janë: provimet, detyrat e kursit/detyrat praktike dhe niveli i aktivizimit në seminare.</p> <p>Bazuar në Rregulloren Mësimore të Programit të Studimit me karakter profesional në “Dizajn i Aplikua dhe Modë” ((Ref. Nr. 7 e DVB) pika 5.2 Mënyra e kontrollit dhe vlerësimit të dijes) nota përfundimtare është rezultante e kombinimit të elementëve të mëposhtëm:</p> <p>Për lëndët e Tipologjisë I</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>a. Provimit përfundimtar (40%)</li> <li>b. Detyrave praktike: 2 (dy) x 30% = (60%)</li> </ol> <p>Për lëndët e Tipologjisë II</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>a. Provimit përfundimtar (40%)</li> <li>b. Provimit të ndërmjetëm (30%)</li> <li>c. Detyrë kursil (20%)</li> <li>d. Nivelit të diskutimit në seminare (10%)</li> </ol> <p>Kontrolli i njohurive realizohet nëpërmjet diskutimeve, edhe me detyra të kontrolluara përgjatë seancave mësimore; Detyrave tematike të përgatitura në mënyrë gjysmë të pavarur nga ana e studentit; Provimit të ndërmjetëm dhe përfundimtar. Në këtë mënyrë student arrin të tregojë njohuritë e përfuara gjatë vitit akademik, si dhe të dëshmojë njohuritë praktike në fushën e dizajnit e modës.</p>
<b>Kriteri 3.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli, studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës /modulit.	<p>Në fillim të çdo semestri studentëve u vihet në dispozicion syllabusi i secilës lëndë (Ref. Nr. 19 e DVB) të parashikuar në programin e studimit. Sic dhe jemi shprehur më parë, përveç rregullores mësimore, çdo syllabus përmban në brendi informacion të qartë dhe të detajuar për mënyrat e kontrollit, format dhe afatet e vlerësimit të dijeve.</p> <p>Prezantimi syllabusit të lëndës/modulit realizohet nga vetë pedagogët e lëndës/modulit në fillimin e saj si dhe materiali është gjithmonë i aksesueshëm në platformën LMS.</p> <p>Të gjitha lajmërimet/komunikimet dhe informacionet shitesë në lidhje me menyrat dhe datat e dorëzimeve/provimeve si dhe vlerësimet realizohen online nëpërmjet LMS duke garantuar një proces transparent (Ref. Nr. 46.2-46.3 e DVB).</p>
<b>Kriteri 4.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik, duke venë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat garantojnë anonimatën, eliminojnë forma të	Në rregulloren e UET (Ref. Nr. 5 e DVB), Neni 24 Mënyra e kontrollit dhe e vlerësimit të dijeve, vërehet se vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. Sic deklarohet dhe në dokumentin “A. IV. Sistemi i vlerësimit të studentëve”

<p>ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>(Ref. Nr. 7.1 e DVB), testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet në mënyrë të vazhdueshme dhe ka qëllim të trefishtë:</p> <p>a. Nxit studentin që të mësojë gjatë gjithë vitit;</p> <p>b. Prodhon një vlerësim më objektiv të studentit, duke e ndarë notën në disa komponentë në krahasim me vlerësimin e bazuar vetëm në një provim;</p> <p>c. Shërben për të vlerësuar ecurinë e kursit gjatë semestrit, nëse studentët janë duke e kuptuar materialin që po ofrohet në kurs;</p> <p>Bazuar në Rregulloren Mësimore të Programit të Studimit me karakter profesional në “Dizajn i Aplikua dhe Modë” ((Ref. Nr. 7 e DVB) pika 5.3.2), provimet zhvillohen me procedurë sekretimi duke mbajtur të fshehtë emrin e studentit në fletën e provimit derisa pedagogu dorëzon provimet e korrigjuara në Sekretarinë Mësimore dhe në këtë mënyrë eliminohen forma të ndryshme abuzimi dhe rritet transparenca.</p> <p>Në RVB deklarohet se gjatë periudhës së pandemisë, pjesa më e madhe e provimeve është zhvilluar online, provimet e ndërmjetme janë hequr, dhe realizimi i të gjitha rubrikave të vlerësimit të provimit, është bërë në formë elektronike (Ref. Nr. 5.1-5.3 e DVB).</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisione provimi, shoqërohet me komente e këshilla mbi procesin e të nxënësve për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet duke ndjekur rregulloren e programit të studimit (Ref. Nr. 7 e DVB, neni 5.3 provime) që studenti dhe stafi akademik duhen të ndjekin. Kjo gjë zbatohet dhe në rast të ankesave nga ana studentit.</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse, duke garantuar njëkohësisht të drejtat e studentëve, për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me këto rregullore.</p>	<p>Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen rregulloren e programit të studimit. Procesi i sekretimi të tezave, favorizon qëndrimin dhe vlerësimin sa më objektiv dhe të paanshëm të pedagogut ndaj vlerësimit të studentit. Sipas rregullave të pasqyruara në rregulloren e programit me karakter profesional, institucioni ndjek hapa dhe procese të cilat arrijnë të vlerësojnë studentin sipas meritës dhe dijeve të nxëna që ai ka marrë gjatë vitit akademik.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>



<b>Standardi III.5</b>	
<b>Zhvillimi i programit të studimit, deri në diplomim, garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët duke dhënë njëkohësisht njohuri të aplikuara dhe kompetenca profesionale lehtësisht të përdorshme në tregun e punës, apo për studime të mëtejshme.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë përfundimin e njohurive, zhvillimin e aftësive profesionale dhe të veçanta të studentëve, që janë në përputhje me rezultatet e pritura të të nxëniet për programet me karakter profesional.</p>	<p>Rregullorja mësimore e programit të studimit me karakter profesional (Ref. Nr. 7 e DVB) është mbështetur në Ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM Nr. 41, dt.24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, në Statutin (Ref. Nr 2 e DVB) dhe Rregulloren e Universitetit Europian të Tiranës (Ref. Nr. 5 e DVB).</p> <p>Kjo rregullore është hartuar në përputhje me objektivat e programit përkatës të studimit, me planin e tij mësimor, me veprimtaritë mësimore të tij, dhe përcakton aspektet organizative të programit të studimit me karakter profesional.</p> <p>Programi i studimit përmban 120 kredite (ECTS) (Ref. Nr. 14, 14.1-14.3 e DVB), zhvillohet në gjuhën shqipe, me kohë të plotë studimi dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike (4 semestra). Në përfundim të ciklit të studimeve lëshohet "Diplomë Profesionale" në "Dizajn i Aplikuar dhe Modë". Objektivi kryesor i këtij programi është formimi i profesionistëve dhe specialistëve në fushën e Dizajnit të Aplikuar dhe Modë. Programi pajis studentët me njohuri teorike, dhe ato praktiko-aplikative në fushën e dizajnit të aplikuar dhe modës. Në këtë program studentët arrijnë të përftojnë dije profesionale, të cilat lidhen ngushtë me kërkesat e tregut të punës si në kontekstin shqiptar, por dhe më gjerë, duke plotësuar në këtë mënyrë nevojat dhe sfidat e reja në realitetin bashkëkohor të fushës së imazhit, dizajnit dhe modës.</p> <p>Programi i studimit është ndërtuar dhe zhvillohet duke ndjekur Rregulloren mësimore të programit të studimit me karakter profesional “Dizajn i aplikuar dhe modë”. Çdo lëndë është e përcaktuar me kredite. Format e mësimdhënies janë: leksione, seminare, praktikë profesionale dhe punim diploma.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton njohuritë e përshtatshme dhe zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit, duke mbështetur diskutimet dhe</p>	<p>Programi i studimit i ofron studentit njohuri të vlefshme e të përgjithshme për të zhvilluar më tej aftësitë rreth procesit krijues. Programi i konceptuar si një gërshtetim i lëndëve praktike me ato teorike, si dhe gjithashtu përfundimi i dijeve në</p>

<p>punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave apo çështjeve të caktuara.</p>	<p>risitë teknologjisë, marrëdhënien, komunikimin e ndërveprimin e njeriut me mjedisin artistik dhe atë human, rrit nevojën për diskutime dhe punën në grup dhe bashkëveprimin midis studentëve dhe pedagogut për të arritur në rezultate sa më të frytshme.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale, duke garantuar realizimin në praktikë të marrëveshjeve me punëdhënësit e aktorët e biznesit në përfitim të formimit praktik të studentëve. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar formimin cilësor dhe për të nxitur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Njohuritë teorike të përftuara gjatë mësimdhënies, gërshetohen nëpërmjet praktikave profesionale, të cilat i mundësojnë studentit të njohë nga afër terrenin dhe mjedisin kreativ. Personeli akademik arrin të gërshetojë njohuritë e format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të konkretizuar teorinë në forma të aplikueshme në krijimtari e dizajn.</p> <p>Gjithashtu një rol të rëndësishëm luan dhe eksperiencat e stafit akademik të përftuar nga mobilitetet apo projekte shkencore, të cilat shërbejnë dhe reflektohen në përmirësimin e mëtejshëm të lëndës dhe dijeve profesionale. Pedagogët të cilët janë efektivë të departamentit janë të përfshirë në projekte, si në programin Erasmus. Për shkak të pandemisë, procesi u ndërpre, por është në pritje të vijimësisë. Një projekt i rëndësishëm ku aktualisht Departamenti i Arteve të Aplikuara është i përfshirë, dhe rrjedhimisht dhe ky program studimi, është projekti në process "<i>Crosswarp Project</i>" mbi traditën e endjes, thurrjes dhe tezgjzgjahut në Shqipëri, i cili po zbatohet në bashkëpunim me disa partnerë të huaj ku janë përfshirë dhe pedagogë të departamentit.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo moduli apo lënde, personeli akademik vlerëson, analizon e shqyrton kompetencat dhe aftësitë e fituara nga studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, duke nxjerrë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orientojnë studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>Stafi pedagogjik i programit, ndjek, udhëzon dhe orienton studentin gjatë gjithë ecurisë së lëndës. Vlerësimet rreth dijeve që ka marrë studenti përgjatë lëndës, kryehen nëpërmjet provimeve, detyrave praktike, ushtrimeve individuale apo në grup që zhvillojnë studentët. Gjithashtu pedagogët në përmbyllje të lëndës, bëjnë dhe një panoramë të përgjithshme të temave të trajtuara në lëndë, si dhe gjithashtu duke kryer konsulta të herpashershme dhe bashkëbisedimet e ndërveprimi që realizohet në prezantimin e punimeve në klasa.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni harton procedura të posaçme, të njohura e publike për diplomimin e studentëve dhe garanton mbështetjen dhe udhëzimin e studentëve në procesin e diplomimit. Ai mban regjistra zyrtarë të studentëve të diplomuar dhe i përditëson ata në fund të çdo viti akademik.</p>	<p>Institucioni ka hartuar procedura, ku orienton studentët në finalizimin e diplomës. Nëpërmjet tutoriatit dhe këshillimit akademik, stafi akademik këshillon studentët duke i ndihmuar në përfundimin me sukses dhe në kohën e duhur të diplomimit. Zhvillimi i diplomës dhe procesi është hartuar në mënyrë të detajuar në rregulloren e diplomimit (ref. B.II. Mbi punimin e diplomës/disertacionit). Zyra e sekretarisë mban regjistra zyrtarë ecurisë akademike të çdo studenti. Ato përditësohen në fund të çdo viti akademik.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Njësia përgjegjëse, personeli</p>	<p>Departamenti dhe stafi akademik orientojnë, ndjekin dhe</p>

<p>akademik dhe udhëheqësit akademikë orientojnë dhe ndihmojnë studentët për përgatitjen e punimit të diplomës, realizimin e veprimtarisë praktike dhe përpunimit të rezultateve, duke garantuar bashkëpunimin edhe me aktorë të jashtëm për realizimin e saj.</p>	<p>ndihmojnë studentët për përgatitjen e produktit final të diplomës, në realizimin e saj dhe përpunimit të produktit final, gjë e cila vjen dhe si rezultat i bashkëpunimit me aktorë të jashtëm.</p> <p>Diploma konsiston në dy tipologji: e para në kryerjen e diplomës me një produkt final, i cili ka karakter aplikativ/praktik. Dhe i dyti konsiston në një provim të përgjithshëm përfundimtar. Për realizimin sa më të mirë të punimit të diplomës, i gjithë stafi akademik ndihmon në orientim dhe në përgatitjen sa më të mirë të produktit final.</p>			
<p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përbushet</b></p>	<p><b>Përbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës III</b></p>	<p><b>Nuk përbushet</b></p>	<p><b>Përbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

#### IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE MBËSHTETJA E STUDENTËVE

<p><b>Standardi IV.1</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për përzgjedhjen dhe cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efçente dhe efektive nga ana e tyre</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton procedura dhe kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura, që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të tij.</p>	<p>UET ka procedura dhe kriteret të përgjithshme dhe specifike të qarta që garantojnë përzgjedhjen e personelit në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore.</p> <p>Më konkretisht Neni 44 i Statutit të UET (Ref. Nr 2 e DVB) jep kriteret e përgjithshme për përzgjedhjen dhe vlerësimin e personelit dhe në rregulloret e brendshme specifike të UET, konkretisht “G.I. Politikat dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik” (Ref. Nr. 11 e DVB) jepen në detaj info mbi qëllimin, kriteret, rastet e vecanta, lektorët e huaj, zhvillimi kurseve jashtë UET, përcaktimin e nevojave për staf të ri, përzgjedhja e kandidatëve për konkurs, zhvillimin e konkursit, komisionet e rekrutimit, lidhjen e kontratave, vlerësimin e performances, certifikimin e personelit, etj.</p> <p>Procesi i rekrutimit në përgjithësi nis në përputhje me nevojat për</p>

	<p>personel akademik, bazuar në planet mësimore që zhvillohen në kuadrin e çdo Fakulteti/Departamenti, si dhe ngarkesat mësimore të miratuara. Propozimi i Departamentit paraqitet në Dekanat dhe përmban profilin profesional të personelit akademik, që propozohet të rekrutohet, argumentimin e këtij propozimi, si dhe në varësi të ngarkesës që pritet të mbulojë, nëse nevojitet pedagog i brendshëm ose i jashtëm. Dekanati, pas miratimit të secilit prej propozimeve të departamenteve ia paraqet Zyrës së Burimeve Njerëzore e cila shpall publikishtnë (Ref. Nr. 11.1 e DVB) (në media dhe në website-n e UET-it) kriteret, mbledh aplikimet dhe bën një seleksionimi paraprak të kandidatëve që plotësojnë kriteret e shpallura. Kandidaturat e seleksionuara paraprakisht marrin pjesë më tej në një konkurs dhe bëhet përzgjedhja e fituesve në bazë të vlerësimit të një Komisioni Rekrutimi për të vijuar më tej me lidhjen e kontratave përkatëse.</p> <p>Kjo procedure është konfirmuar dhe nga takimi me përgjegjësit, stafin dhe ZBNJ gjatë vizitës së GVJ ku janë vënë në dispozicion dhe procesverbale dhe materialet e rasteve konkrete të kërkuar në mënyrë rastësore nga GVJ.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program, personin përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, përfshirë tutorët apo vëzhguesit e praktikës në institucionet partnere, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ të angazhuar.</p>	<p>Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Në RVB dhe materialet e marra/kërkuara gjatë vizitës janë vënë në dispozicion infot për të treja vitet që program është aktiv.</p> <p>Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program, lëndën që mbulon/drejton, titujt dhe gradat, statusi PAE apo PAK, ngarkesa mësimore, CV përkatëse, etj (Tabelat 6, 7, 8 dhe 12 të “Ref. Nr. 0.2 -Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB - DP DAM”). Gjithashtu jepen të dhëna për përgjegjësit, drejtues departamenti, tutorët e praktikave (Tab. 5.3 të Ref.Nr. 0.2 Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB - DP DAM”), etj.</p> <p>Bazuar dhe në vizitën e GVJ, është referuar që çdo vit stafi akademik raporton në lidhje me përditesimet e CV-se se vet, publikimet, pjesëmarrjet në konferenca/aktivitete shkencore e artistike, pjesëmarrje në projekte, realizimin e ngarkesës mesimore, etj. Të gjitha të dhënat raportohen paraprakisht Departamentit dhe raportet apo materialet depozitohen më tej dhe në Zyrën e Burimeve Njerëzore. Ky process verifikohet dhe me raportin e dorëzuar me RVB (Ref.Nr. 43.2 Raportim i punës krijuese artistike dhe kërkimore shkencore_DAA 2018-2021) si dhe te dosjet e pedagogëve ku përveç materialeve standarte (kontrata e punës përfshirë anekset e ngarkesave, diplomat, vlerësimet e punës, CV, ID, Libreza, etj, gjenden dhe pjesëmarrje të ndryshme në aktivitete, kurse shtesë, projekte, vlerësime, etj (Ref. Nr. 44.1, 44.2 e DVB).</p> <p>Ne vitin akademik 2020-2021 (Tab. 6.3 të Ref. Nr. 0.2 e DVB),</p>



	<p>në Programin e Studimit me karakter profesional në “Dizajn i Aplikuar dhe Modë” angazhohen: <b>1 Prof. As. (PAE); 4 Dr. (3 PAE dhe 1 PAK); 10 MSc. (9 PAE dhe 1 PAK)</b>, ku nga shqyrtimi i CV-ve të vëna në dispozicion (Ref. Nr. 20 e DVB) dëshmohet në përgjithësi një ekperiencë e gjerë në fushën e arteve dhe në përputhje me lëndët që mbulojnë në program.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimit me karakter profesional dhe për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Sic është përmend dhe në kriteret më lart, departamenti, në varësi të nevojave për të balancuar ngarkesat apo plotësuar specialitetet e kërkuara, zhvillon në bashkëpunim me Zyrën e Burimeve Njerëzore dhe procesin e rekrutimit të stafit akademik. Përveç akteve ligjore në fuqi, UET ka dhe në rregullore të posacme në lidhje me shpërndarjen e ngarkesës mesimore (Ref. Nr. 11 e DVB) “G. II. Mbi kriteret e shpërndarjes së ngarkesës mesimore”). Si rregull është drejtuesi i departamentit që përgjigjet për respektimin e shpërndarjen e ngarkesës tek personeli akademik bazuar në rregullat dhe kriteret e ligjit dhe vetë institucionit, duke raportuar për këtë shpërndarje te Zyra e Burimeve Njerezore ne fillim te çdo semestri. Nga ana tjetër, vetë stafi PAE dorëzon te Zyra e Burimeve Njerezore një formular të posacëm raportimi (formati G.II.1) për realizimin e ngarkesës vjetore.</p> <p>Institucioni mban të dhëna të sakta në lidhje me ngarkesat e stafit të angazhuar në këtë program, të përpunuara si ngarkesë të plotë bashkë me lëndët në programe/cikle të tjera (Tab. 4 ne Ref.Nr. 25 i DVB- “Ngarkesa mesimore ne auditor e stafit akademik te programit DP Dizajn i Aplikuar dhe Mode” dhe ngarkesa për çdo lëndë të vetë programit. (Tabelat 12.1, 12.2 dhe 12.3 te Ref. Nr. 0.2 -Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB - DP DAM”), etj. Nga ana e vlerësimit të ngarkesës, e analizuar dhe në raportet e Departamentit (Ref. Nr. 38 e DVB), gjykojmë që, përsa i përket angazhimit në këtë program, ngarkesa është konform aktesh ligjore dhe rregulloreve, gjithsesi shikohet qe ka një ngarkese konsistente për një pjesë të stafit për shkak të angazhimit dhe në programe të tjera, cka do rekomandonim që instistucioni të përkujdesej brënda mundësive qe të “uli” ngarkesën për këto raste duke i dhënë mundësi të fokusohen më shumë në rritjen cilësore të lëndëve dhe rritjen personale me anë të kërkimit shkencor/aktivitetit artistik.</p> <p>Nga pikëpamja cilësore ka një sistem të ngritur i cili garanton rekrutimin e stafit në përputhje me profilin (Ref. Nr. 11 e DVB) si dhe performance e tij në raport me mësimdhënien, ku perfshihen vlerësime nga student (Ref. Nr. 40 e DVB), kolegë dhe eprorët (Ref. Nr. 30.8 e DVB), dhe me kërkimin shkencor apo angazhimin në aktivitete apo projekte (Ref. Nr. 30, 30.1-30.10 e DVB mbi systemin e SBC).</p>



	<p>Përsa i përket infrastrukturave (Ref. Nr. 42 e DVB), nga vizita e kryer në institucion dhe nga të dhënat e raportit, rezulton që stafi është vënë në kushte të mira për të kryer detyrat e tij në mënyrë profesionale, duke iu referuar këtu ambjenteve për pedagogët, kushtet e klasave, labororet, <i>atelier</i>-et, bibliotekat, etj.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit, përmes organizimit të programeve specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, si dhe mbështetjen për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Bazuar në RVB (Ref. Nr. 33 dhe 35 e DVB) dhe nga diskutimet gjatë vizitës në institucion mund të gjykohet që institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit.</p> <p>Ky angazhim mund të shikohet në disa drejtime:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Organizimii trajnimeve specifike në lidhje me metoda inovative të mësimdhënies, përfshirë dhe përdorimin e teknologjive dhe platformave online si platforma TEAMS (për mësimdhënien) dhe LMS (për të gjitha aktivitetet e tjera formuese), të cilat rezultuan vecantërisht të domosdoshme gjatë mbylljes për shkak të COVID (Ref. Nr. 46.4 e DVB).</li> <li>-Angazhimi i stafit në projekte ndërkombëtare të cilat lejojnë ngritjen e kapaciteteve në drejtime të shumëfishta, si mësimdhënia, kërkimi, menaxhimi, sigurimi i cilësisë, etj (Ref. Nr. 34.7 dhe 43.1 e DVB).</li> <li>-Stimulimi dhe krijimi i mundësisë së pjesëmarrjes në konferenca apo aktivitete të organizuara nga vetë UET.</li> <li>-Stimulimi dhe mbështetja e pjesëmarrjes në konferenca apo aktivitete të tjera jashtë UET.</li> <li>- Krijimi i mundësisë së shkëmbimit akademik me institucione partnere në kuadër të projekteve ndërkombëtare (Ref. Nr. 34.7 dhe 43.1 e DVB).</li> <li>-Krijimi i hapësirave për publikime në revistat institucionale.</li> </ul> <p>Një instrument i gjetur në rregullore gjithashtu gjykojmë që mund të jetë motivues (Ref. Nr. 11 e DVB), me konkretisht “Çmimet për vlerësimin e performancave ekselente” të cilat synojnë evidentimin, promovimin, nxitjen dhe motivimin e rasteve të performances ekselente të personelit akademik e jo vetëm. Institucioni ka ngritur një strukture ekselente të menaxhimit të projekteve ndërkombëtare dhe gjykojmë që nxitja e pjesëmarrjes së stafit në projekte të tilla me mbështetjen e asaj zyre mund të sillte rezultate akoma më positive në rritjen e kapaciteteve qoftë logjistike ashtu dhe të mësimdhënies apo kërkimit.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<b>X</b>

**Standardi IV.2**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të përshtatshëm sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit me karakter profesional**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Gjatë vizitës dhe bazuar në materialet e dorëzuara në DVB rezultoi që institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike (Ref. Nr. 42 e DVB). Në DVB deklarohet që sipërfaqja totale e godinave të Universitetit është rreth 11,500 m<sup>2</sup> pa përfshirët sipërfaqen përreth godinave që shërben si lulisht, vend pushimi dhe parkim.</p> <p>“Kompleksi” është i përbërë nga 3 objekte të emërtuara Godina A, B dhe C ku dy të parat kanë nga 4 kate me 1000m<sup>2</sup> secila dhe godina C akomodon bibliotekën. Përgjithësisht salat e leksioneve/seminare janë të përqendruara ta godina A dhe B kurse labororet, <i>atelier</i>-ët, hapësirat e praktikave janë te godina B.</p> <p>Në këto godina për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike ka 10 salla me sipërfaqe totale 1510 m<sup>2</sup> dhe 1515 vende, 9 salla 70 vëndëshe me sipërfaqe 100 m<sup>2</sup> secila dhe 14 salla seminari me sipërfaqe 45 m<sup>2</sup> secila me nga 35 vende. Gjithashtu janë 3 laboratore informatike me sipërfaqe 45m<sup>2</sup> secila me kapacitet 35 vende si dhe një sallë interneti me sipërfaqe 165 m<sup>2</sup> me 80 <i>pc</i> duke siguruar dhe praktikave që kanë të bëjnë me punët dixhitale por dhe shpjegimet teorike apo përdorimin e sistemit LMS apo TEAMS ku studentët mund të marrin gjithë info/materialet e leksioneve apo ndjekjen e leksioneve dhe online.</p> <p>Duke pasur parasysh që në Programin e Studimit me karakter profesional në “Dizajn i Aplikuar dhe Modë” viti me regjistrimet më të larta ka qënë me 33 studentë (Ref. Nr. 27 e DVB), gjykohet që hapësirat mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore, si: klasat, labororet, studiot e mjediset e tjera janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Mjediset mësimore si klasat, labororet, studio/<i>atelier</i>-et e mjediset e tjera janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit. Sallat për leksionet dhe seminarat janë të gjitha të pajisura me mjete audio vizive si PC, projektorë dhe foni. Labororet e informatikës janë pajisura gjithashtu me <i>softëaret</i> përkatës në varësi të programit mësimor/lëndës që i shërbejnë, përfshirë dhe një laborator i pajisur me teknologji VR (syze dhe <i>soft</i>-et përkatëse).</p> <p>Në përgjithësi ambjentet universitare janë të mbuluara nga sinjali Ëi-Fi të cilin stafi dhe studentët mund ta aksesojnë lirisht <i>ëeb</i>-in. Falë platformave të UET, si LMS, TEAMS, etj, bëhet e mundur</p>



	<p>që studentët në kohë reale të azhurnohet me informacione apo materialet/ leksione të pedagogëve, mundësia e ndjekjes së leksioneve online, etj.</p> <p>Gjykohet që ambientet mësimore janë të pajisura me mjetet didaktike të nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas fushës specifike të programit profesional, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Sic u përmend më lart, ambientet që i shërbejnë Programit të Studimit me karakter profesional në “Dizajn i Aplikuar dhe Modë” përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi (Ref. Nr. 42 e DVB).</p> <p>Më konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Klasat për leksione teorike dhe seminare kanë kapacitetet për të akomoduar numrin e studentëve të regjistruar në këtë program si dhe janë pajisura me mjete audio vizive si PC, projektorë dhe foni për zhvillimin e një procesi mësimdhënie përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</li> <li>-Laboratori i informatikes në të cilin kryhet procesi I mësimdhënies së lëndëve që kanë të bëjnë me informatikën, <i>ëeb design-in</i>, përpunimin grafik, modelimin, etj.</li> <li>- Laboratori i Arteve Pamore dhe Dizajnit, me një sipërfaqe rreth 250m<sup>2</sup>, është i pajisur me mjete bazë për punë praktike të studentëve të programit.</li> <li>- Tirana Design Academy, një hapësirë kursesh formimi dhe pune e cila shërben dhe për praktikë të studentëve të programit Programit të Studimit me karakter profesional në “Dizajn i Aplikuar dhe Modë”</li> </ul> <p>Në institucion, potencialisht në shërbim të programit, kryesisht për aktivitete prazantuese dhe ekspozimi, gjenden dhe hapësira të tjera si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Salla Aula Magna me një sipërfaqe rreth 200 m<sup>2</sup>, me një kapacitet akomodues prej 125 persona, e pajisur me një post të konceptuar për regjinë dhe produksionin audio e video.</li> <li>- Laboratori i Arteve Skenike – me një sipërfaqe rreth 250m<sup>2</sup></li> <li>-Holli i Godinës A të UET</li> </ul>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/eve të studimit që ofron.</p>	<p>Institucioni ka 4 laboratorë informatike (Ref. Nr. 42 e DVB):</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Lab 205 B me 25 PC dhe video projektor;</li> <li>- Lab 206 B me 35 PC dhe video projektor;</li> <li>- Lab 207 B me 35 PC dhe video projektor;</li> <li>- Lab 208 B me 80 pc (laboratori i internetit).</li> </ul>

	Në dispozicion është dhe laborator i inovacionit me 24 PC. Laboratori i informatikës në të cilin punojnë studentët Programit të Studimit me karakter profesional në “Dizajn i Aplikuar dhe Modë” është i pajisur me <i>software</i> -at e nevojshme për aplikimet e lidhura me programin e studimit.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale, internship-it dhe veprimtarive të tjera praktike thelbësore për programet me karakter profesional.	Praktika e studentëve zhvillohen në disa dimensione. Së pari janë praktikatat të lidhura drejtpërdrejtë me lëndë specifike të programit, të cilat mund të realizohen nën ndjekjen e pedagogëve përgjegjës në laboratorët e institucionit (Laboratori i Informatikës, Laboratori i Arteve Pamore dhe Dizajnit). Së dyti, praktika profesionale mund të zhvillohet në ambientet e institucioneve me të cilat janë lidhur marrëveshje bashkëpunimi për këtë qëllim. Në RVB është dorëzuar “LISTA E SUBJEKTEVE/ INSTITUCIONEVE BASHKËPUNUESE PËR PROGRAMIN E STUDIMIT DHE PRAKTIKAT PROFESIONALE DEPARTAMENTI ARTE TË APLIKUARA” (Ref. Nr. 32, 34.1-34.12 dhe Tab. 5.1-5.3 e Ref. Nr. 0.2 e DVB), e përbërë nga 14 institucione/sipermarrje/organizata, nga të cilat 4 janë në nivel bashkëpunimi me departamentin ndërkohe pjesa tjetër në bashkëpunim më të gjerë në nivel fakulteti apo universiteti. Në këtë kuadër UET ka një zyrë të posaçme që synon nxitjen e lidhjes së bashkëpunimeve me kompani të ndryshme si dhe për orientimin e studentëve, përfshirë dhe borde të tregut të punës (Ref. Nr. 12, 12.1-12.4 e DVB). Se fundi, studentët janë të lirë të zgjedhin një institucion/kompani ku dëshirojnë të kryejnë praktikën e tyre pas miratimit të departamentit.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Niveli i përmbushjes</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>
<b>Standardi IV.3</b>				
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse e të posaçme të mësimnxënies, bibliotekën e literaturën dhe mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit dhe realizimin cilësor të tij</b>				
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit dhe krijon kushte për akses të barabartë e pa pagesë dhe të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Biblioteka (Ref. Nr. 42, 45, 45.1 e DVB) është e vendosur në Godinën C, me një sipërfaqe prej 300 m2 dhe 150 vende leximi. Fondi i Bibliotekës për vitin akademik 2020-2021 është: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Totali i librave Bruto, Periodik, CD &amp; Harta 6425 tituj.</li> <li>• Libra në gjuhën shqipe 4931 tituj.</li> <li>• Libra në gjuhë të huaj 1466 tituj.</li> <li>• Periodik total përafërsisht 170 tituj.</li> <li>• Periodik shqip përafërsisht 105 tituj.</li> <li>• Periodik në gjuhë të huaj (anglisht, frëngjisht, italisht)</li> </ul>			


	<p>përafërsisht 67 tituj.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• CD &amp; Harta 85</li> </ul> <p>Orari i shpallur i Bibliotekes është: Henë-Premte 9:00-20:00 dhe e Shtunë 9:00-17:00, ndërkohë që në RVB deklarohet që gjatë sezonit të provimeve është me orar të zgjatur.</p> <p>Biblioteka është e aksesueshme nga të gjithë studentët e UET dhe pa pagesë. Biblioteka ka dhe 12 PC si dhe ambientet janë të mbuluara nga rrjeti wi-fi duke garantuar kështu dhe aksesin në arkivat/fondin e literatures apo platformave online ku ka abonimet/aksesin e saj institucioni.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë mësimore bazë, ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, të mjaftueshme dhe të përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikkës së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni garantohet dhe kontrollon që biblioteka të jetë e pajisur me literaturën mësimore bazë, ndihmëse, në gjuhën shqipe dhe të huaja, në përputhje me literaturën e deklaruar nga sillabuset e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore të programit të studimit (Ref. Nr. 45.1 e DVB).</p> <p><i>E thënë kjo, do rekomandohej që të pasurohej akoma më tej me tituj librash për fushën e programit e në mënyrë specifike me revista të fushës duke garantuar kështu një përditësim sa më të mire me risitë e studimet më të fundit.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit dhe duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Sic u përmend dhe më lart, ambientet e bibliotekave lejojnë akses të lirë e të barabartë dhe pa pagesë për studentët si dhe janë të pajisur me pc dhe të mbuluara nga rrjeti wi-fi duke garantuar kështu dhe aksesin në arkivat/fondin e literatures apo platformave online ku ka abonimet/aksesin e saj institucioni si (Ref. Nr. 45, 45.1, Tab. 17 e Ref. Nr. 0.2 e DVB):</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Sage&amp;EBSCO</li> <li>2. Questia</li> <li>3. ASTM Compass</li> <li>4. Edward Elgar Publishing – Elgar Online Platform</li> </ol> <p>Aksesi është i mundur dhe në arkivat e bibliotekës ku gjenden kopje elektronike të një pjese të literaturës si dhe ku është e mundur një pjesë e leksioneve/materialeve mësimore I vihet në dispozicion studentit falë platformës LMS.</p> <p>Në RVB dhe nga biseda me pedagogët, deklarohet që pasurimi i bibliotekës bëhet në mënyrë të vazhdueshme në bazë të kërkesave të Departamentit por dhe të pedagogëve të vecantë duke mundësuar sigurimin e titujve të kërkuar në fillim të vitit akademik me anë të blerjeve të teksteve universitare dhe librash të tjera që janë pjese e lëndëve përkatëse të kurrikulave. Blerjet janë të tiplogjive të ndryshme, nga ato nga panaireset, blerjet online, abonime online, etj.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, përmes bashkëpunimit me aktorë të jashtëm, të angazhuar në realizimin e programit mësimor, duhet t'u lehtësojnë dhe</p>	<p>Institucioni, përmes bashkëpunimit me aktorë të jashtëm, të angazhuar në realizimin e programit mësimor, lehtëson dhe garanton studentëve mbështetjen dhe përdorimin e burimeve e</p>

<p>garantojë studentëve mbështetjen dhe përdorimin e burimeve e logjistikës së nevojshme të institucioneve partnere, në varësi të natyrës së angazhimit të tyre në procesin formues teorik, praktik dhe profesional të studentëve.</p>	<p>logjistikës së nevojshme të institucioneve partnere.</p> <p>Institucioni ka një sërë marrëveshjesh me institucione apo kompani për zhvillimin e praktikave mësimore ku palët bien dakort që studentëve u vihen në dispozicion asetet e institucionit pritës në varësi të natyrës së angazhimit të studentëve (Ref. Nr. 32, 34.1-34.12 dhe Tab. 5.1-5.3 e Ref. Nr. 0.2 e DVB).</p> <p>Gjithashtu institucioni ka krijuar dhe nja rrjetë shumë të gjerë bashkëpunimi akademik, shkëmbimi dhe projektesh të përbashkëta me institucione locale dhe ndërkombëtare ku me anë të shkëmbimëve, studentvt apo stafi mund të përfitojnë nga asetet e institucioneve partnere në varësi gjithmonë të tipologjisë së marrveshjes (Ref. Nr. 34.7 e DVB).</p> <p>Së fundmi, Biblioteka e UET (Ref. Nr. 42, 45, 45.1 e DVB) është pjesë e sistemit COBISS (Sistemi dhe shërbimet e perbashketa bibliografike online). COBISS.Net është një rrjet ku perfishihen vende të rajonit të Evropës Juglindore, duke perfaqesuar një model organizativ të lidhjes së bibliotekave në sistemin kombëtar të informacionit bibliotekar me katalogim të përbashket, duke siguruar kështu dhe një informacion më të gjerë për mundësi gjetjeje literature nga studentët (natyrisht aksesit është në varësi të marrveshjeve që mund të krijohen).</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni parashikon koston financiare të programit të studimit profesional, mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi dhe raportin financiar të përvitshëm dhe në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi.</p>	<p>Në tabelat permbledhese të RVB, më konkretisht Tabela 18.1, 18.2 e Ref. Nr. 0.2 e DVB, jepen respektivisht kostot mesatare për çdo student dhe buxheti vjetor dhe origjina. Institucioni ka bën vlerësime dhe raporte vjetore dhe përsa I përket kostove për çdo student duke garantuar mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit.</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Financimi i një programi studimi profesional duhet të sigurojë e të garantojë mbulimin e të gjitha burimeve dhe veprimtarive të qëndrueshme dhe operative, të lidhura e që janë në funksion të realizimit të programit të studimit, duke garantuar njëkohësisht qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit e në vijim.</p>	<p>Financimi i programit studimi profesional siguron dhe garanton mbulimin e të gjitha burimeve dhe veprimtarive të lidhura e që janë në funksion të realizimit të programit të studimit, duke garantuar njëkohësisht qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

**Standardi IV.4**

**Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek, zbaton politika e procedura institucionale dhe i jep formacion të plotë e të hollësishëm studentëve mbi programin e studimit me karakter profesional, pranimin, përzgjedhjen, përparimin akademik, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton, zbaton dhe bën publike politika, procedura e kriteret të qarta e të kuptueshme për pranimit e studentëve, përparimin e tyre përgjatë kursit të studimit, të vlerësimin të dijeve dhe të diplomimit, të cilat garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Procedura dhe kriteret e pranimit, përparimit përgjatë kursit të studimit, të vlerësimin të dijeve dhe të diplomimit janë të përcaktuara qartë në një serë dokumentash të institucionit. Statuti i UET (Ref. Nr 2 e DVB) në Nenin 10 përcakton detyrimin e ndjekjes së standarteve dhe legjislacionit në fuqi nga MASR si dhe bërjes publike të çdo informacioni për programet e studimit. Neni 40 i tij jep udhëzime për diplomat ndërkohë që Kreu VII trajton integralisht detyrimet dhe të drejtat e studentëve.</p> <p>Rregullorja e UET (Ref. Nr 5 e DVB) parashikon norma të nevojshme për funksionimin e UET-it, të procesit akademik, të marrëdhënieve të UET-it me studentët, etj. Në vecanti KREU III-PRANIMI I STUDENTËVE, KREU V-KONTROLLI DHE VLERËSIMI I DIJES, dhe KREU IX- DIPLOMIMI. Institucioni ka gjithashtu një sërë rregulloresh specifike në lidhje me , procedurat e kriteret të pranimit të studentëve, përparimin e tyre përgjatë kursit të studimit, të vlerësimin të dijeve dhe të diplomimit (Ref. Nr 7.1, 7.2, 10, 27.2 dhe 28 e DVB).</p> <p>Të gjitha informacionet në lidhje me procedura dhe kriteret e pranimit, përparimit, vlerësimin të dijeve dhe të diplomimit janë të përcaktuara qartë në Rregulloret Mësimore të programeve specifike të studimit (Ref. Nr 7 e DVB).</p> <p>Informacioni është i plotë dhe dhe publik në faqen ëeb të institucionit (<a href="http://www.uet.edu.al">www.uet.edu.al</a>), te zyrat si ajo e pranimit, e këshillimit të karrieres si dhe nga pedagogje përgjegjës për programe specifike.</p> <p>Në asnjë rast nuk vërehen përjasje diskriminuese duke garantuar barazi dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë apo studentë të regjistruar, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet rregullatore të vetë institucionit.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të përgjithshme dhe/ose të veçanta për pranimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve në programet e studimit me karakter profesional dhe udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me to.</p>	<p>Sic u theksua më lartë, çdo program studimi, përvec rregullave të përgjithshme në Statutin (Ref. Nr 2 e DVB) dhe Rregulloren e UET (Ref. Nr 5 e DVB), ka një Rregullore Mësimore specifike ku ndër të tjera përcaktohen dhe kriteret për “PRANIMET NË PROGRAMIN E STUDIMIT” ((Ref. Nr 7 e DVB, pika 2 e Rregullores Mësimore të Programit të Studimit me karakter profesional në “Dizajn i Aplikuar dhe Modë”).</p> <p>Bazuar në këtë rregullore është Senati Akademik, bazuar kriteretve specifike që mund të përcaktohen paraprakisht nga Departamenti, që miraton vendimin për kriteret e pranimit e</p>






	<p>përzgjedhjes së tyre dhe bëhen publike çdo fillim viti akademik para fillimit të regjistrimeve.</p> <p>Informacioni bëhet publik si online në rrjete sociale apo <i>ëeb</i>-in zyrtar, ashtu dhe nëpërmjet Zyrës së Pranimit, Zyrës së Këshillimit Karrieres dhe Kujdesit ndaj Studentit apo prezantimit të tyre gjatë aktiviteteve si <i>tour-eve</i> në gjimnaze, <i>open days</i>, "Javet e Regjistrimit", etj.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve, zhvillimin e veprimtarive praktike e profesionale të programit dhe institucionet bashkëpunuese në këto veprimtari, vlerësimin të dijeve e aftësive të studentëve dhe diplomimit.</p>	<p>Institucioni publikon dhe jep në dispozicion një sërë materialesh informative dhe rregullore për studentët e regjistruar. Ndër këto Rregulloria Mësimore e Programit të Studimit me karakter profesional në "Dizajn i Aplikuar dhe Modë" (Ref. Nr 7 e DVB) e cila jep informacion i plotë në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve. Në të shpjegohen struktura e programit të studimit, kohëzgjatjen e studimeve, kalimi nga një vit në tjetrin (kalimi në vitin pasardhës me marrjen minimalisht 30 ECTS, pika 5.6 e rregullores), objektivat e programit të studimit, kreditet, frekuentimin, praktikat profesionale, rishikimin e programit, transferimet dhe njohjen e kualifikimeve të mëparshme, etj.</p> <p>Institucioni vë në dispozicion një informacion të gjerë në lidhje me funksionimin e praktiva profesionale, më konkretisht "B.I. Mbi praktikën profesionale" (Ref. Nr 32.1 e DVB). Megjithëse studenti është përgjegjës për gjetjen e structures ku do e zhvilloj, strukturat përgjegjëse për zhvillimin dhe vlerësimin e praktikës janë Departamenti dhe Zyra e Këshillimit të Karrierës. Departamenti harton sillabuset, kalendaret, caktimin e pedagogut përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të praktikave profesionale, shpërndan e mbledh formularët a plikimin dhe vlerësimin, miraton institucionet e praktikave, etj. Zyra e Këshillimit të Karrierës ndihmon në krijimin e kontakteve/marrëveshjeve me kompani, organizata apo institucione me qellim zhvillimin e praktikave profesionale. Konkretisht janë active në këtë moment 14 institucione/sipermarrje/organizata me të cilat kanë marrëveshje bashkëpunimi për zhvillimin e praktikave profesionale (Ref. Nr 32 e DVB).</p> <p>Informacioni për kriteret dhe procedurat e vlerësimin të dijeve e aftësive të studentëve është gjithashtu shumë I qartë në Rregulloren Mësimore të Programit të Studimit me karakter profesional në "Dizajn i Aplikuar dhe Modë". Në të jepet informacion i plotë dhe i hollësishëm në lidhje systemin e vlerësimin, mënyra e kontrollit dhe vlerësimin të dijes, provimet, riprovimet dhe bartja, etj. Syllabuset e secilës lëndë kanë një informacion dhe më të detajuar për çdo lëndë lidhur me kriteret dhe procedurat e vlerësimin të dijeve dhe aftësive të studentit.</p> <p>Një informacion i saktë jepet gjithashtu për diplomimit në</p>

	<p>programin e studimit (pika 8. DIPLOMIMI)</p> <p>Informacionet përveç se në sistemin LMS (ku çdo student akseson me kredencialet e tij) janë të aksesueshme dhe pranë zyrës së sekretarisë apo koordinatorëve të programit si dhe në fillim të çdo semestri u shpjegohen studentëve nga vetë koordinatorët dhe nga pedagogët e lëndëve. Institucioni orienton studentët dhe përmes seancave orientuese dhe këshilluese në fillim të vitit akademik dhe më tej në mënyrë periodike (Ref. Nr 10.1-10.3, 33.1 e DVB).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin, kohëzgjatjen e programit të studimeve, mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Informacioni lidhur me strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve është i aksesueshëm për studentët vazhdimisht. Ky informacion garantohej që nga faza para regjistrimit nëpërmjet aktiviteteve të organizuara nga institucioni si <i>tour-et</i> në gjimnaze, <i>open days</i>, Zyrës së Pranimit apo broshurave, faqes web të institucionit apo e më tej gjatë fazes së regjistrimit me anë të Rregullores Mësimore të Programit të Studimit me karakter profesional në “Dizajn i Aplikua dhe Modë” (Ref. Nr 7 e DVB) dhe Programi i studimit dhe plani mësimor të cilat i bashkangjiten si shtojcë.</p> <p>Rregulloria përfshin qartë info mbi strukturën e programit të studimit (pika 3.1), kohëzgjatjen e studimeve (pika 3.2), objektivat e programit të studimit (pika 3.3), kreditet (pika 4), etj.</p> <p>Mundësitë e punësimit janë gjithashtu të sqaruara duke dhënë profilet potenciale apo tipologjitë e institucioneve apo kompanive ku studentët mund të punësohen. Në institucion është e ngritur gjithashtu Zyra e Këshillimit të Karrierës (Ref. Nr. 12 e DVB) e cila ndihmon në krijimin e kontakteve/marrëveshjeve me kompani, organizata apo institucione në funksion të zhvillimit të praktikave profesionale të detyrueshme por dhe në aksesin në tregun e punës duke shpërndarë informacion për vende potenciale, duke i trajnuar studentët në hartimin e CV, Letrës së motivimit &amp; Korrespondencën me zyrat e Burimeve Njerëzore, Mentorim &amp; Netëorking, organizimin e panireve të punës, trajnime për intervista pune si dhe në krijimin e databazave dhe përpunimin e statistikave për punësimin e Alumni në mënyrë që të marr <i>inpute</i> për përmirësimin e programit në këtë drejtim apo për nxitjen e rrjetëzimit.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen, veprimtaritë formuese dhe informacion të gjerë e të përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Përveç informacioneve të dhënë gjatë aktiviteteve të ndryshme, zyrat përkatëse dhe rregulloret, studentëve u vihen në dispozicion dhe programi i studimit dhe plani mësimor (Ref. Nr. 14, 14.1-14.3 e DVB) të cilat kanë info të detajuara për modulet dhe lëndet dhe organizimin/ ndarjen ndër vite në bazë të tipologjive dhe veprimtaritë formuese. Gjithashtu Syllabuset e secilës lënde (Ref. Nr. 19 e DVB) që i vihen në dispozicion që para fillimit të vitit, përmbajnë një informacion shumë të detajuar dhe shterrues për çdo lëndë si titullarin e lëndës, ngarkesën në ECTS, vitin</p>

	<p>akademik dhe semestrin, kontakte të pedagogut, përmbledhje dhe qëllimin e lëndës, konceptet themelore dhe temat që trajtohen, metodat pedagogjike, format e kontrollit/vlerësimit të dijes, literature e detyruar, literature e rekomanduar, etj.</p> <p>Institucioni ka një kalendar dhe info të qartë mbi organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij (Ref. Nr 10.1-10.3, 33.1, 42 e DVB). Përpara çdo fillim viti ka një aktivitet të posaçëm që janë javët e regjistrimit në të cilën sqarohen të gjitha proceset, shërbimet, infrastrukturën, etj., ndërkohë që gjatë gjithë vitit studentët kanë mbështetjen e Zyrës së Kujdesit (Ref. Nr. 12 e DVB), Sekretaria (Ref. Nr. 9 e DVB), koordinatorët e programeve, keshilluesit akademik (Ref. Nr. 27.2 e DVB), etj.</p> <p>Të gjitha materialet dhe informacionet janë të aksesueshme në çfarëdo moment nga çdo student në platformën UET LMS (Ref. Nr. 46.1-46.3 e DVB).</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Institucioni ka aktiv dhe funksional një sistem të brendshëm të menaxhimit të informacionit, UET LMS (Ref. Nr. 46.1-46.3 e DVB).</p> <p>Platforma UET LMS-Learning Management System, e cila funksionon si një database personal për çdo student nga mund të aksesohet në çdo informacion si programi, syllabuset, leksionet, notat dhe kreditet, oraret, etj., por duke funksionuar njëherazi dhe si platformë shkëmbimi për dorëzimin e punëve, forum komunikim, shkëmbim mesazhesh, njoftime specifike e të përgjithshme, etj. Stafit akademik ka gjithashtu akses për lëndët që është pjesëmarrës nga ku mund të menaxhojë literaturën e lëndëve perkatese, caktimin e detyrave të kursit, depozitimin e leksioneve, vlerësimet, forume diskutimi online me studentët, etj.</p> <p>Me anë të kësaj mënyre studentët kanë një informacion të plotë dhe të përditësuar në lidhje me programin e tyre. Përveç LMS, informacioni mund të shkëmbehet dhe me forma të tjera dixhitale/online si UMS-University Management System, e-mail, Eëbsite zyrtar i UET dhe një sërë instrumentash të furnizuara nga pale të treta si Microsoft Teams, etj., të cilat përdoren në raste specifike.</p> <p>Keto instrumenta të menaxhimit dhe shkëmbimit të informacionit, vecantërisht platforma LMS, janë lehtësisht të aksesueshme si nga ambientet e UET (nga salla e internetit apo nëpërmjet PC personale nëpërmjet rrjetit wi-fi) ashtu dhe nga ambientet personale të studentëve apo ambiente të tjera në distancë nëpërmjet internetit.</p>




Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

#### Standardi IV.5

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit me karakter profesional**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin e daljen në tregun e punës.</p>	<p>Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin e daljen në tregun e punës. Sistemi është i përbërë nga dy platforma kryesore (të ndara dhe autonome nga njëra tjetra), UMS-University Management System dhe UET LMS-Learning Management System (Ref. Nr. 46 e DVB).</p> <p>UMS-University Management System, shërben si instrument për ruajtjen, administrimit dhe përpunimin e informacioneve që kanë të bëjnë me aspekte të menaxhimit të institucionit, të programeve të studimit dhe të studentëve.</p> <p>Me konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Sistemi menaxhimin e aspekteve të përgjithsme të universitetit shërben për databazat e programeve të studimit, kalendaret e leksioneve, oraret mesimore, fondet e librave të bibliotekes, etj.</li> <li>- Sistemi i menaxhimit të programeve të studimit dhe lëndëve mundëson hartimin e programeve të studimit me precizitetin e kategorive të lëndëve, kreditet përkatëse, kushtet e regjistrimit të lëndëve, si dhe detyrime që duhet plotësuar deri në përfundimin e programit të studimit.</li> <li>- Sistemi i menaxhimit të studentëve ka të bëjë me informacionin bazë të çdo studenti si të dhenat personale, të dhëna regjistrimi, lëndët përkatëse, vlerësime, listat e notave, njohje kredite për transferime dhe çdo informacion tjetër nga pranimit deri në diplomim.</li> </ul> <p>Ndërkohë që UMS është një platformë menaxhimi gjithëpërfshirëse por e menaxhuar dhe e aksesueshme nga persona përgjegjës të stafit, institucioni nga ngritur dhe një platformë UET LMS-Learning Management System (Ref. Nr. 46.1-46.3 e DVB), e cila funksionon si një database personal për çdo student nga mund të aksesohet në çdo informacion si programi, lëndët, vlerësimet, materiale mësimore, etj.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i</p>	<p>Bazuar në sasinë e informacion të përmbajtur në sistemin e</p>

<p>menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe të partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>menaxhimit të informacionit UMS (Ref. Nr. 46 e DVB), bëhet lehtësisht e mundur që të administrohet dhe monitorohet informacioni dhe dokumentacioni në lidhje me personelin akademik dhe administrative. Bazuar në RVB, sistemi ka një "zone" që quhet "Portali i pedagoqeve", i cili përmban informacion mbi projektet kerkimore, mundëson hedhjen e notave në sistem, njoftime, etj. Njëherazi, dhe platforma tjetër, UET LMS (Ref. Nr. 46.1-46.3 e DVB), është në gjendje të japi info në lidhje me aktivitetet e stafit pasi në të gjenden leksionet, materiale audio/visive, lajmërimi, vlerësime, etj.</p> <p>Sic raportohet dhe në RVB, në PC që i përkasin stafit aksesohet databaza e institucionit me emërtimin "Dokumenta UET", nga ku secili anetar i institucionit mund të aksesojë të dhëna lidhur me strategjitë, rregulloret, urdhërat administrative, standardet, informacione apo dokumentacione që i takon personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe të partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Në të dyja platformat kryesore që janë sqaruar më lart, është I mundur akses nga personat përkatës në varësi të pozicionit dhe përgjegjësisë që mund të kenë.</p> <p>Sistemi UMS është një platformë e gjerë dhe gjithëpërfshirëse, përveç manualit të dorëzuar me RVB mbi funksionimin e tij, gjatë vizitës në sekretari ishte e mundur që të furnizohej çdo info në lidhje me studentët, programet, lëndët e vecanta, etj, por akses në këtë platformë është I mundur vetëm për stafin administrativ apo akademik në seksione të vecanta.</p> <p>Ndërkohë, platforma UET LMS-Learning Management System, e cila funksionon si nje database personal per çdo student nga mund te aksesohet ne çdo informacion si programi, syllabuset, leksionet, notat dhe kreditet, oraret, etj., mund të aksesohet nga stafi akademik për furnizimin me materialet për lëndën përkatës apo nga studentët të cilët mund të gjejnë info mbi avancimin e tyre apo materiale mësimore dhe informacione të tjera.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit ka të integruar mundësi të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve. Platforma LMS, është lehtësisht të aksesueshme si nga ambjentet e UET ashtu dhe nga ambjentet personale të studentëve nëpërmjet internetit, duke mundësuar përdorimin e forumeve apo mesazheve brënda platformës si për komunikim ashtu dhe për shkëmbim materialesh.</p> <p>Krahas përdorimit të platformës LMS, stafi akademik dhe studentët mund të komunikojnë online dhe nëpërmjet Microsoft Teams apo e-mail-eve zyrtare me të cilat anë pajisur si stafi dhe studentët.</p> <p>Përdorimi i këtyra formave të komunikimit është konfirmuar dhe</p>

	nga vetë studentët, duke theksuar rëndësinë vecantërisht gjatë mësimit online për shkak të pandemisë.			
<b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	<p>Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrative. Falë përdorimit të këtyre platformave mund të garantohej një kontroll dhe vlerësim i aktivitetit të stafit në plotësimin e detyrave të tij.</p> <p>Gjithashtu falë platformave të ngritura, është e mundur gjenerimi i një numri të madh statistikash dhe të dhënash komplekse që shërbejnë si për raportimet e parashikuara nga ligji ashtu dhe për vlerësimin cilësor dhe sasior të punës së kryer nga stafi, cilësinë e studentëve dhe performancën e tyre, etj.</p> <p>Bazuar në RVB, analiza dhe raporte gjenerohen në fund të çdo semestri të cilat i vihen në dispozicion drejtuesve apo KSBC, i cili falë dhe mundësisë së bërjes së procesit të vlerësimit të stafit online (nga ana e studentëve), mund të monitorojë në mënyrë gjithëpërfshirëse cilësinë e procesit mësimor.</p>			
<b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Website zyrtar i UET, <a href="http://www.uet.edu.al">www.uet.edu.al</a> , përfshin informacione mbi programet e studimit, stafin akademik, aktivitete të ndryshme, njoftime, etj. E gjithë përmbajtja rezulton në dy gjuhë, shqip dhe anglisht.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

### Standardi V.1

**Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin, në programin e studimit dhe i vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika, procedura dhe kriteret të pranimit, përparimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit të studentëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta	Procedura dhe kriteret e pranimit, përparimit, transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme janë të përcaktuara qartë në një seri dokumentash të institucionit. Më konkretisht në Statuti i UET (Ref. Nr 2 e DVB) shprehet qarte (Neni 10) për detyrimin e ndjekjes së standardeve dhe legjislacionit në fuqi nga MASR si dhe bërjes publike të çdo info-je për programet e studimit

<p>rregullatore dhe që janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>(rregulla për to të caktuara nga Neni 30 e më tej i Statutit). Në nenin 40 jepen udhëzime për diplomat ndërkohë që Kreu VII trajton integrisht detyrimet dhe të drejtat e studentëve.</p> <p>Gjithashtu, Rregullorja e UET (Ref. Nr. 5 e DVB) përmban norma dhe parashikime të nevojshme për funksionimin e UET-it, të procesit akademik, të marrëdhënieve të UET-it me studentët, etj. Në vecanti KREU III-PRANIMI I STUDENTËVE, KREU V-KONTROLLI DHE VLERËSIMI I DIJES, KREU VII-TRANSFERIMET DHE MOBILITETI I STUDENTËVE dhe KREU IX- DIPLOMIMI.</p> <p>Në mënyrë akoma më specifike, të gjitha informacionet në lidhje me procedura dhe kriteret e pranimit, përparimit, transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme janë të përcaktuara qartë në Rregullore specifike (Ref. Nr 7.1, 7.2, 10, 27.2 dhe 28 e DVB) dhe Rregulloret Mësimore të programeve specifike të studimit (Ref. Nr. 7 e DVB).</p> <p>Informacioni është i plotë dhe i aksesueshëm nga publiku nepermjet një sëri kanalesh, që nga faqja ëeb e institucionit (<a href="http://www.uet.edu.al">www.uet.edu.al</a>) e deri te një seri zyrash si ajo e pranimit, e këshillimit të karrieres si dhe nga pedagogje përgjegjës për programe specifike.</p> <p>Institucioni ka të hartuara dhe zbaton politika dhe procedura të qarta që nga pranimi dhe deri në përfundim të studimeve e më tej.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje dhe orientimin drejt tregut të punës, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në të gjithë dokumentacionin e pare si dhe nga bisedat si me strukturat ashtu dhe me stafin dhe studentët, rezultojnë politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje dhe orientimin drejt tregut të punës, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit. Procedurat e pranimit janë të mirëpërcaktuara dhe të bazuara në legjislacionin në fuqi duke garantuar akses të njëjtë për të gjithë, brenda kuotave dhe rregullave të sanksionuar nga ligji dhe rregulloret, madje diku stimuluar ekselencën. Ndjekja e studentit përgjate studimeve dhe më tej në tregun e punës është e njëjtë për të gjithë.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve dhe, përpara fillimit të çdo viti akademik, udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Çdo program studimi, përveç rregullave të sanksionuara në Statutin (Ref. Nr 2 e DVB) dhe Rregulloren e Institucionit (Ref. Nr. 5 DVB), ka një Rregullore Mësimore të veçantë (Ref. Nr. 7 e DVB) e hartuar në përputhje me objektivat e programit përkatës të studimit, me planin e tij mësimor si dhe me veprimtaritë mësimore të tij. Në të përcaktohen qartë aspektet organizative të programit të studimit duke përfshirë dhe 'PRANIMET NË PROGRAMIN E STUDIMIT' në pikën 2 të saj.</p> <p>Bazuar në këtë rregullore, numri maksimal i studentëve që mund të regjistrohen dhe mënyrat e përzgjedhjes së tyre, përcaktohen me vendim të Senatit Akademik, bazuar kriterëve specifike që mund të</p>

	<p>përcaktohen paraprakisht nga Departamenti, dhe bëhen publike çdo fillim viti akademik para fillimit të regjistrimeve.</p> <p>Informacioni vendoset në dispozicion të publikut si online, ashtu dhe nëpërmjet Zyrës së Pranimet, Zyrës së Këshillimit Karrieres dhe Kujdesit ndaj Studentit apo javëve orientuese ("Javet e Regjistrimit" sic cilësohen në RVB) dhe aktiviteteve të tjera të organizuara nga institucioni në kuadër të 'Politikave të prezantimit dhe promovimit të UET'(Ref. Nr. 48 dhe 51 e DVB).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve, kalimit nga një vit akademik në tjetrin, procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.</p>	<p>Në rregulloren mësimore të programit të studimit me karakter profesional "DIZAJN I APLIKUAR DHE MODË" (Ref. Nr. 7 e DVB) jepet informacion i plotë në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve duke shpjeguar në mënyrë të plotë strukturën e programit të studimit, kohëzgjatjen e studimeve, kalimi nga një vit në tjetrin (pika 5.6 e rregullores), objektivat e programit të studimit, kreditet, frekuentimin, praktikat profesionale, rishikimin e programit, transferimet dhe njohjen e kualifikimeve të mëparshme, etj. Kto informacione së bashku me një sërë informacionesh të tjera të parashikuara në rregulloren dhe statutin e institucionit i jepen paraprakisht studentëve (Ref. Nr. 5, 7, 7.1, 7.2, 10, 27.2 dhe 28 e DVB).</p> <p>Një informacion akoma më i detajuar në lidhje me çdo lëndë të vecantë të programit i vihet në gatishmëri studentëve dhe nga pedagogët e lëndëve të cilët vendosin në sistemin UET LMS, syllabusin së bashku me leksionet, literaturën e detyrueshme dhe të rekomanduar të lëndës.</p> <p>Këto materiale përvec se në sistem janë të aksesueshme dhe pranë zyrës së sekretarisë apo koordinatorëve të programit si dhe në fillim të çdo semestri, u shpjegohen studentëve nga vetë koordinatorët dhe nga pedagogët e lëndëve.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit dhe diplomimit në programin e studimit. Vetë Rregullorja Mësimore e Programit të Studimit me karakter profesional në "Dizajn i Aplikua dhe Modë" (Ref. Nr. 7 e DVB) jepet informacion i plotë dhe i hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve ku përfshihet sistemi i vlerësimit (pika 5.1), mënyra e kontrollit dhe vlerësimit të dijes (pika 5.2), provimet (pika 5.3), riprovimet dhe bartja (pika 5.4), përmirësimet (pika 5.5), etj. Një informacion i saktë jepet gjithashtu për diplomimit në programin e studimit (pika 8. DIPLOMIMI)</p> <p>Syllabuset e secilës lënde (Ref. Nr. 19 e DVB), të bazuara në legjislacionin në fuqi dhe në dokumentin "A.III. Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës dhe të përdorimit të literaturës" (Ref. Nr. 39 e DVB), përmbajnë gjithashtu një informacion më të</p>




	<p>detajuar dhe specific për çdo lëndë lidhur me kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentit.</p> <p>Në lidhje me kriteret dhe procedurat për përgatitjen e Provimit të Përgjithshëm Përfundimtar (PPP)/ Projektit Aplikativ (Diplomimit) ne programin e studimit, përvec informacioneve të vëna në dispozicion në rregulloret dhe dokumentat e ndryshme, institucioni i orienton studentët përmes seancave orientuese dhe këshilluese në fillim të vitit akademik dhe më tej në mënyrë periodike (Ref. Nr. 7.1, 7.2, 10 e DVB).</p> <p>Të gjitha materialet janë të aksesueshme në sistemin UET LMS dhe pranë zyrës së sekretarisë apo koordinatorëve të programit si dhe në fillim të çdo semestri, u shpjegohen studentëve nga vetë koordinatorët dhe nga pedagogët e lëndëve.</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Program i studimit ka një Rregullore Mësimore dhe program studimi të qartë e të plotë të cilat janë publike në çdo kohë dhe shpërndahen dhe publikohen dhe çdo fillim viti akademik me përditësimet e mundshme para fillimit të regjistrimeve.</p> <p>Informacioni është i aksesueshëm si online në web apo rrjete sociale, ashtu dhe nëpërmjet Zyrës së Pranimit, Zyrës së Këshillimit Karrieres dhe Kujdesit ndaj Studentit (Ref. Nr. 12 e DVB) apo duke u shpërndarë në aktivitetet si javët "Javët e Regjistrimit" ku grupe pedagogesh apo stafi administrative japin të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me kriteret e pranimit apo transferimit, organizimin dhe përbajtjen e programit, kohëzgjatjen, mënyrat e mësimdhënies, mënyrat e vlerësimit, rregulloret e ndryshme të universitetit, mundësitë e punësimit, etj.</p> <p>Përvec aktivitetet të mësipërme, institucioni, në kuadër të "Politikave të prezantimit dhe promovimit të UET" (Ref. Nr. 48 dhe 51 e DVB), sic dhe është konfirmuar nga stafi apo studentët dhe të paraqitura në "D.I.1.1. Informimi dhe ndërgjegjësimi" i dokumentit "D.I. Mbi politikën, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve" (Ref. Nr. 27.1 e DVB), organizon dhe aktivitetet të tjera (Ref. Nr 10.1-10.3, 33.1 e DVB) për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Organizim i takimeve informuese në gjimnaze;</li> <li>- Organizimi i seminareve, i tryezave të rrumbullakëta, i leksioneve të hapura dhe i veprimtarive të tjera me karakter mesimor-informues-argetues;</li> <li>-Përgatitja dhe shpërndarja e materialeve informuese si fletpalosje, postera, spote TV, etj.;</li> </ul>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

**Standardi V.2**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënës dhe mundësitë e punësimit**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni informon në mënyrë të hollësishme studentët për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve dhe ve në dispozicion të tyre, informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit me karakter profesional.</p>	<p>Informacioni në lidhje strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve, modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit me karakter profesional është i aksesueshëm për studentët në çfarëdo momenti.</p> <p>Ky informacion i vihet në dispozicion që nga faza para regjistrimit nëpërmjet Zyrës së Pranimit apo broshurave, faqes web të institucionit (<a href="http://www.uet.edu.al">www.uet.edu.al</a>) apo aktiviteteve të organizuara nga institucioni e më tej gjatë fazes së regjistrimit me anë të Rregullores Mësimore të Programit të Studimit me karakter profesional në “Dizajn i Aplikua dhe Modë” dhe Programi i studimit dhe plani mësimor të cilat i bashkangjiten si shtojcë.</p> <p>Më konkretisht, rregulloria (Ref. Nr. 7 e DVB) përfshin info mbi pranimet (pika 2), strukturën e programit të studimit (pika 3.1), kohëzgjatjen e studimeve (pika 3.2), kalimi nga një vit në tjetrin (pika 5.6 e rregullores), objektivat e programit të studimit (pika 3.3), kreditet (pika 4), etj.</p> <p>Programi i studimit dhe plani mësimor (Ref. Nr. 14, 14.1-14.3 e DVB) kanë info të qarta për modulet dhe lëndet dhe organizimin/ ndarjen ndër vite në bazë të tipologjive dhe veprimtaritë formuese. Ndërkohë Syllabuset e secilës lënde (Ref. Nr. 19 e DVB), përmbajnë një informacion më të detajuar dhe specifik për çdo lëndë si titullarin e lëndës, ngarkesën në ECTS, vitin akademik dhe semestrin, kontakte të pedagogut, përmbledhje dhe qëllimin e lëndës, konceptet themelore dhe temat që trajtohen, metodat pedagogjike, format e kontrollit/vlerësimit të dijes, literature e detyruar, literature e rekomanduar, etj.</p> <p>Të gjitha materialet janë të aksesueshme në sistemin UET LMS dhe pranë zyrave përkatëse si dhe prezantimi i informacioneve/materialeve i bëhet studentëve në faza të ndryshme nga zyrat përkatëse apo nga vetë koordinatorët dhe nga pedagogët e lëndëve.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët mbi praktikat profesionale në kuadër të realizimit të programit të studimit, partnerët dhe institucionet bashkëpunuese ku parashikohen të</p>	<p>Praktika profesionale e studentëve, bazuar në Rregulloren Mësimore të Programit të Studimit me karakter profesional në “Dizajn i Aplikuar dhe Modë” (Ref. Nr. 7 e DVB), organizohet, ndiqet dhe mbikëqyret nga Drejtuesi i Departamentit përkatës, në</p>



<p>realizohen, si dhe mundësitë e punësimit e mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>bashkëpunim me Zyrën e Karrierës. Kjo praktikë është pjesë integrale e kurrikulës dhe e detyrueshme për studentët, duke mbajtur një peshë prej 6 ECTS, pra 150 orë pune nga të cilat 120 në “ambjentet” e zhvillimit të praktikës (Ref. Nr. 14, 14.1 e DVB).</p> <p>Institucioni ka një “manual” shterrues në lidhje me funksionimin e praktiva profesionale, më konkretisht “B.I. Mbi praktikën profesionale” (Ref. Nr. 32.1 e DVB). Megjithëse studenti është përgjegjës, strukturat përgjegjëse për zhvillimin dhe vlerësimin e praktikës janë Departamenti dhe Zyra e Këshillimit të Karrierës.</p> <p>Departamenti përkujdeset për hartimin e sillabuseve, kalendarit, ekspert që referojne/bordi i punës, mbikëqyrjen e vizitave studimore, caktimin e pedagogut përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të praktikave profesionale, shpërndan e mbledh formularët a plikimin dhe vlerësimit, miraton institucionet e praktikave, etj (Ref. Nr. 6 e DVB).</p> <p>Zyra e Këshillimit të Karrierës përkujdeset për krijimin e kontakteve/marrëveshjeve me kompani, organizata apo institucione në funksion të zhvillimit të praktikave profesionale. Përtej asistencës për/gjatë praktikave, kjo zyrë asiston studentët dhe në tregun e punës duke shpërndarë informacion për vende potenciale por dhe duke i trajnuar studentët në hartimin e CV, Letrës së motivimit &amp; Korrespondencën me zyrat e Burimeve Njerëzore, Mentorim &amp; Netëorking, organizimin e panairove të punës, trajnime për intervista pune si dhe në gjurmimin, krijimin e databazave dhe përpunimin e statistikave për punësimin e Alumni (Ref. Nr. 12 e DVB).</p> <p>Në RVB është dorëzuar “LISTA E SUBJEKTEVE/ INSTITUCIONEVE BASHKËPUNUESE PËR PROGRAMIN E STUDIMIT DHE PRAKTIKAT PROFESIONALE DEPARTAMENTI ARTE TË APLIKUARA” (Ref. Nr. 32 dhe 34.1-34.12, Tab. 5.1-5.3 të Ref. Nr. 0.2 e DVB), e përbërë nga 14 institucione/sipermarrje/organizata, nga të cilat 4 janë në nivel bashkëpunimi me departamantin ndërkohe pjesa tjetër në bashkëpunim më të gjerë në nivel fakulteti apo universiteti.</p> <p>Nga takimi me studentët është referuar qe kanë asistencë dhe info të qarta si për procesin ashtu dhe për mundësite e praktikave. Gjithashtu një pjesë e tyre ishin të punësuar ose të vetëpunësuar dhe sic parashikon dhe rregulloria atyre i njihet si pjese e praktikës profesionale.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Studentet kane në dispozicion informacionet e plota dhe të përditësuara mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Institucioni ofron një sërë mekanizmesh për këtë si aktivitete informuese, faqja web, zyrat përkatëse si sekretarita, Zyra e Kujdesit ndaj Studentit, koordinatorët, IT, etj., si dhe i gjithë</p>

	informacioni është i arritshëm online nëpërmjet platformave UET LMS dhe Microsoft Teams duke siguruar mbarëvajtjen e procesit, e konfirmuar dhe nga studentët, edhe online gjatë fazes së pandemisë, pavarësisht vështirësive objective për një program professional.			
<b>Kriteri 4.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	<p>Institucioni ka aktiv dhe funksional një sistem të brendshëm të menaxhimit të informacionit. Bazuar në RVB dhe nga verifikimet gjatë vizitës në institucion, rezulton që shpërndarja e informacionit bëhet me një sërë mënyrash si:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. E-mail, ku çdo staf akademik, administrative dhe student ka e-mail personal me ane të cilave mund të shkëmbehet informacion zyrtar.</li> <li>2. Platforma UET LMS-Learning Management System, e cila funksionon si një database personal për çdo student nga mund të aksesohet në çdo informacion si programi, syllabuset, leksionet, notat dhe kreditet, oraret, etj., por duke funksionuar njëherazi dhe si platformë shkëmbimi për dorëzimin e punëve, forum komunikim, shkëmbim mesazhesh, njoftime specifike e të përgjithshme, etj (Ref. Nr. 46.1-46.3 dhe 46.5 e DVB).</li> <li>3. UMS-University Management System, e cila shërben si database me informacionet bazë të çdo student (te dhenat personale, te dhena regjistrimi, listat e notave, etj (Ref. Nr. 46 e DVB).</li> <li>4. Website zyrtar i UET ku jepen informacione mbi programet e studimit, stafin akademik, aktivitete të ndryshme, njoftime, etj (www.uet.edu.al).</li> <li>5. Një sërë instrumentash të furnizuara nga pale të treta si Microsoft Teams, etj., të cilat përdoren në raste specifike (Ref. Nr. 46.4-46.5 e DVB).</li> </ol> <p>Një Keto menyrë komunikimi dhe informimi, vecantërisht platforma LMS, janë lehtësisht të aksesueshme si nga ambientet e UET ashtu dhe nga ambientet personale të studentëve nëpërmjet internetit. Përdorimi i tyre është konfirmuar dhe nga vetë studentët, vecantërisht gjatë mësimin online për shkak të pandemisë.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi V.3

**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit me karakter profesional, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi**

informatik të brendshëm	
Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në vitet paraardhëse në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit. Bazuar në të dhënat e RVB dhe takimit të bërë në sekretari ku janë pare dhe regjistrat themeltar, programi është në vitin e tretë të regjistrimeve ku të diplomuar rezultojnë 4 studentë, të gjithë të regjistruar normalisht në V.A. 2018-2019 dhe të diplomuar pas përfundimit të dy viteve të programit (Ref. Nr. 27 e DVB).</p> <p>Materialet janë të aksesueshme si në regjistra, ashtu dhe në systemin e brendshëm të menaxhimit të informacionit. Gjithashtu kopje dhe procesverbale gjenden dhe të printuara në dosjet perkatëse, përfshirë të studentëve.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon dhe ruan statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Në V.A. 2018-2019 ka 10 të regjistruar (2 të c' regjistruar), në V.A. 2019-2020 33 të regjistruar (6 të c' regjistruar) dhe në V.A. 2020-2021 vetëm një të regjistruar, të gjithë për here të pare e asnjë të transferuar. Këto statistika janë vënë në dispozicion të GVJ në RVB dhe janë verifikuar dhe gjatë vizitës në institucion. Institucioni disponon dhe ruan statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik.</p> <p>Të gjitha këto info janë të regjistruara në regjistrat fizike (themeltar, amze, etj.) dhe gjithashtu në sistemin e menaxhimit të brendshëm. Të dhënat e raportuara ishin korrekte dhe janë vënë në dispozicion kërkesat për largime/pezullime si dhe vendimet e miratimit nga institucioni të cilat gjenden dhe në dosjet personale të studentëve. Gjithashtu rezultonte informacioni dhe në procesverbalet e notave apo regjistrave duke shënuar në krah të studentit statusin e tij.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre, përfshirë punësimin eventual të tyre.</p>	<p>Studentët kanë dosjet e tyre me të gjitha informacionet dhe dokumentat e dorëzuara që nga regjistrimi i tyre, përfshirë dhe infot në rastet e largimeve.</p> <p>Zyra e Kontratave, si zyrë bashkërenduese me Sekretarinë (Ref. Nr. 9 e DVB), bën regjistrimin paraprak të studentit dhe garanton/ndjek plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm për regjistrimin duke u kujdesur më tej për pajisjen me numrin e matrikullimit dhe regjistrimin dhe hedhjen e gjithë të dhënave për çdo student në UMIS-Sistemi i Menaxhimit të Informacionit të Universitetit (Ref. Nr. 46 e DVB). Ky profil pasurohet me të dhëna të mëtejshme gjatë zhvillimit të programit të studimeve deri në diplomimin e tyre.</p> <p>Sic dhe u tha më pare, përvec informacioneve në UMS-University Management System, e cila shërben si database me informacionet bazë të çdo student, për çdo student ekzistojnë dhe kopje fizike i</p>

	<p>të gjithë informacioneve themeltare.</p> <p>Ndërkohë ecuria e tyre gjatë studimeve e deri në diplomim ndiqet edhe nga personeli akademik gjatë orëve të tutoriatit dhe këshillimit akademik (Ref. Nr. 27.2 e DVB), ashtu si dhe nga Zyra e Kujdesit ndaj Studentit. Ecuria e studimeve është e gjitha e regjistruar si në regjistra themeltar e notash ne kopje fizike ashtu dhe online, madje totalisht e aksesueshme dhe nga vetë studenti nëpërmjet Platforma UET LMS-Learning Management System.</p> <p>Nëpërmjet kontaktit periodik me të diplomuarit, Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Shoqatës Alumni, gjeneron dhe informacione në lidhje me punësimin e tyre duke nxitur kështu dhe një njohje më të mire të tregut apo krijimin e urave lidhëse me të (Ref. Nr. 29 e DVB).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Sic dhe u prek në kriteret më lart, të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen/gjenerohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit UMIS-Sistemi i Menaxhimit të Informacionit të Universitetit. Përveç UMIS, sistemi është i përbërë dhe nga platforma tjetër, UET-LMS. Të dhënat, sic dhe u verifikua gjatë vizitës, janë lehtësisht të verifikueshme dhe aksesit i tyre bëhet nëpërmjet personave kompetentë/të autorizuar si IT apo sekretaria. Përveç sistemeve të back-up elektronik, i gjithë informacione mbahet dhe në formë fizike.</p> <p>Institucioni krijon, përpunon dhe ruan dhe menaxhon përmes sistemit të brendshëm të informacionit të gjitha statistikatat ne lidhje me aplikimet, regjistrimet, njohjet, pezullimet, cregjistrimet, vlerësimet, mesataret, diplomimet, etj.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe të shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Institucioni harton raporte në lidhje me cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, konkretisht me RVB është dorëzuar dhe tabela “Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve (Tabela 21 e Ref. Nr. 27 e DVB)”, ku vihet re që ka një rritje të mesatares hyrëse nga V.A. 2018-2019 (i pari i këtij program) në atë të fundit, pra 2020-2021 duke shkuar nga 5.8 në 6.95 (pavarësisht se duke qënë vetëm një i regjistruar nuk mund të merret në reference të mirëfilltë për krahasime, por dhe V.A. 2019-2020 me një mesatare hyrëse 6.35 tregon një trend rritjeje të mesatares hyrëse. Përsa i përket mesatares në dalje prej 7.18 tregon një ecuri dhe vlerësim të balancuar me nivelin hyrës të studentëve (dhe këtu është herët për vlerësime të mirëfillta pasi bëhet fjalë për 4 të diplomuar).</p> <p>Përsa i përket punësimit, bazuar në të dhënat e raportuara, nga 4 të diplomuar, të 4 janë të punësuar, nga të cilët 3 të punësuar në profilin e studimit. Nga bisedat me studentët, rezulton që dhe një pjesë e tyre janë të punësuar në fusha të lidhura me profilin dhe interesi ndaj këtij program ishte për të pasuruar më tej njohuritë e tyre (Tabela 23 e Ref. Nr. 29 e DVB).</p> <p>Bazuar në raport dhe në procesverbale takimesh të vëna në</p>

	dispozicion, rezulton që institucioni kujdeset nëpërmjet kanaleve të shumëfishta për marrjen e informacioneve për kerkesat e tregut me qëllim përmirësimin e treguesve të punësimit (në nivel politikash pasi për këtë program është objektivisht shumë herët për të gjykuar performancën në tregun e punës). Kjo arrihet nëpërmjet informacioneve të marra nga të diplomuarit nëpërmjet Zyrës Se Karrierës, Shoqatës Alumni, Bordeve të Tregut të punës si dhe nga studime periodike të tregut të punës (Ref. Nr. 12, 12.1, 12.4, 17 e DVB).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

#### Standardi V.4

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Studentët në UET kanë përfaqësi në disa dimensione. Se pari ekzistojnë Këshillat Studentor, organizime në nivel njësie kryesore të cilat zgjidhen çdo dy vjet nga vetë studentët (Neni 51 i statutit UET. Nëpërmjet e këshillit mund të shprehen mendime e propozime për të gjitha problemet, planet, programet, etj. Keto këshilla janë thelbësore dhe për përfshirjen e studentëve në organe të tjera drejtuese të universitetit.</p> <p>UET parashikom përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese.</p> <p>Më konkretisht, studentët kanë përfaqësinë e tyre në një sërë organe drejtuese akademike të sanksionuara në Statutin e UET (Ref. Nr 2 e DVB) si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Senati akademik: Bazuar në Nenin 19.2.4 të Statutit, studentët kanë një përfaqësi prej 3 personash në Senat me një mandate 2 vjecar (Kryetari i Këshillit Studentor dhe 2 studentë të zgjedhur nga Këshilli Studentor)</li> <li>- Dekanati: Bazuar në Nenin 19.5 të Statutit, studentët përfaqësohen në Dekanat nga Kryetari i Këshillit Studentor të Fakultetit)</li> <li>- Këshillin e Etikes: Bazuar në Nenin 19.5 të Statutit, studentët kanë të drejtën e propozimit te Rektori, nëpërmjet Këshillit Studentor, të njërit prej 4 anëtarëve që i</li> </ul>

	<p>propozohen për miratim Senatit.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Komisionin e Sigurimit të Brendshëm të Cilesisë: Bazuar në Nenin 19.7.4 pika c. të Statutit, studentët duhet të kenë një përfaqësues të Keshillit Studentor në KSBC.</li> </ul> <p>Jo me më pak rëndësi janë dhe përfshirja e tyre në focus grupet, në mbledhjet e departamenteve si dhe në vlerësimet që bëhen për pedagoget/lëndët.</p> <p>Duke parë rëndësinë e organeve vendimmarrëse në të cilat studentët përfaqësohen, gjykohet që i ofrohet mundësia për të qënë pjesë aktive në të gjitha proceset e universitetit që ndikon drejtpërdrejtë në cilësinë e mësimdhënies dhe të programeve.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose e përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Sic u shprehem në kriterin më lart, studentët përfaqësohen në organet më të larta drejtuese të institucionit. Pjesëmarrja e tyre është e sanksionuar në të gjitha aktet rregullatore themelore të institucionit.</p> <p>Përveç përfaqësimit në nivel përfaqësimi, çdo student ka mundësinë e vlerësimit në mënyrë anonime për çdo lëndë/pedagog në fund të çdo semestri (Ref. Nr. 5- Rregullore UET, Neni 22.2 - Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies së personelit akademik). Ky vlerësim behët online nëpërmjet platformës online LMS dhe rezultatet përpunohen dhe shpërndahen padagogëve dhe drejtuesve, të cilët mund të ngrejnë dhe komisione për <i>follow up</i>. Në RVB është dorëzuar dhe formulari “G.III.4.2/ FORMULAR VLERËSIMI I STUDENTËVE PËR PEDAGOGUN DHE LËNDËN” (Ref. Nr. 40 e DVB) ku shikohet mundësia e vlerësimit të një sërë pikash si mësimdhënia, vlerësimi dhe sqarimi, këshillimi akademik dhe një hapësirë e lirv për komente qoftë për gjera positive dhe negative.</p> <p>Një instrument tjetër në dispozicion të studentëve janë dhe organizimi i <i>focus grupeve</i> me studentët dhe pjesëmarrja në mbledhjet e hapura të departamentit (të referuar si një here në muaj) ku studentët mund të shprehin opinionet dhe mendimet e tyre.</p> <p>Gjithashtu studentët kanë në dispozicion dhe persona apo struktura të tjera mbështetëse si koordinorët e programeve, Zyrën e Kujdesit ndaj Studentit, platformën LMS, formularët e ankesave (Ref. Nr. 40.1 e DVB- D.VI.3.3 / FORMULAR PËR ADRESIMIN E KËRKESAVE TË STUDENTËVE), etj. Nga takimi me studentët e Programit të Studimit me karakter profesional në “Dizajn i Aplikua dhe Modë” është perceptuar një komunikim i mirë ndërmjet studentëve dhe organeve vendimmarrëse apo pedagogëve ku është shprehur gatishmëria e tyre për të marr parasysh e ndjekur problematikat apo sugjerimet.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni</p>	<p>Bazuar në Nenin 35 të Rregullores Mësimore të UET (Ref. Nr. 5 e DVB), në të cilën trajtohen transferimet, thuhet që “në çdo rast</p>



<p>duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>studenti duhet të ndjekë në UET së paku një vit akademik. Studenti duhet të fitojë përmes programit të UET jo më pak se 25% të ECTS-ve në kategoritë e lëndëve A-D, si dhe të përmbushë detyrimet përmbyllëse (Kategoria E) të programit të studimit.” Një informacion shumë i qartë e i detajuar jepet në “D.II. Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin e studentëve” (Ref. Nr. 28 e DVB).</p> <p>Te regjistruarit e këtij program nuk rezultojnë të jenë të transferuar apo të kenë kërkuar njohje nga studime të mëparshme, gjithsesi bazuar dhe në rregulloret dhe planin mësimor nuk gjykohet se ka proceduar burokratike. Ngarkesa mësimore duket mjaft e balancuar dhe konform normave ku ngarkesa e orëve në “auditor” për vitin e parë është 575 orë, kurse në vitin e dytë 592.5 (pa 150 orët e praktikës), për një total në dy vite prej 1167.5 orësh përkundrejt ngarkesës totale prej 3000 orësh të parashikuara si orë në auditor dhe studimi individual për 120 ECTS totale të programit (Ref. Nr. 14.1 e DVB).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Institucioni ka një rregullore të qartë përpara i përket hartimit dhe rishikimit të kurrikulave të programeve (Ref. Nr. 13 e DVB), ashtu sic ka dhe legjislacion të posaçëm për normat e “rishikimit”. Megjithatë, sic dhe është shpjeguar në kriteret më sipër, ka një sërë mekanizmash të cilat i mundësojnë studentëve të jenë pjesë e përmirësimit të programeve. Kjo është e mundur së pari nga vlerësimet e vecanta që i bëjnë çdo lëndë (në fund të çdo semestri) të cilat mund të japin inpute pedagogëve, përgjegjësve të grup lëndëve, koordinatorëve, drejtuesve të departamentit, KBSC, etj., për të përmirësuar syllabuset dhe vetë lëndët.</p> <p>Mundësia e pjesëmarrjes në mbledhjet e departamenteve (një herë në muaj) apo <i>focus grupet</i> i jep mundësinë që të shtrijë problemet dhe kërkesat e tyre në lidhje me përmirësime të programit. Jo më pak i rëndësishëm është dhe përfaqësimi i tyre në organet drejtuese dhe vendimarrëse.</p> <p>Të gjitha këto mundësitë japin inpute lehtësisht të verifikueshme e të matshme. Natyrisht ngelet në dëshirën e studentëve nëse i shfrytëzojnë apo jo mundësitë si dhe më tej vlerësimet e mundësisë së implementimit është dhe në varësi të objektivitetit të kërkesës si dhe mundësisë reale dhe ligjore për të akomoduar kërkesat.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Studentët kanë mundësinë të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit.</p> <p>Përveç mundësive të ankesës drejtpërdrejtë te pedagogu, ka një sërë personash ku mund të përcillen ankesat si koordinatorët e programeve, Zyra e Kujdesit ndaj Studentit, vetë drejtuesit e Departamentit (me anë të “D.VI.3.3 / FORMULAR PËR</p>

	<p>ADRESIMIN E KËRKESAVE TË STUDENTËVE”) (Ref. Nr. 40.1 e DVB).</p> <p>Gjithashtu në vlerësimet që bëjnë studentët për çdo lëndë (Ref. Nr. 40 e DVB), një seksion i vecantë i është dedikuar” vlerësimi dhe sqarimit”, ku studentit i kërkohet të vlerësoj nëse kriteret e vlerësimi janë bërë të qarta që në fillim, nëse vlerësimi i pedagogut ka qenë i drejtë, nëse student ka marr komente të hollësishme mbi rezultatet e punës së tij gjatë lëndës, etj (natyrisht I referohet procesit pasi pyetëtori bëhet para vlerësimi final).</p> <p>Në Rregulloren Mësimore të Programit të Studimit me karakter profesional në “Dizajn i Aplikua dhe Modë” (Ref. Nr. 7 e DVB) parashikohen dhe procedurat për kërkesë rivlerësimi (Neni 5.8), ku “në rast se studenti ka ankesë për pikët që ka marrë në një nga komponentët e vlerësimi (kolokium, provim i ndërmjetëm, detyrë kursi/detyra praktike, provim përfundimtar), pasi ka konsumuar procedurën e sqarimit me pedagogun e lëndës ai mund t’i drejtojë Drejtuesit të Departamentit një kërkesë me shkrim, ku të parashtrijë arsyet mbi të cilat ai bazon ankesën” dhe më tej parashikohet ngritja e një komisioni për shqyrtimin e kërkesës dhe për rivlerësimin e komponentit të ankimuar, rivlersim ky përfundimtar.</p>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

**Standardi V.5**

**Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>Institucioni ka rregullore, procedura dhe njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve. Informimi dhe shërbimi ndaj studentëve nis që nga momenti i interesimit për programet e ofruara e vijon më tej gjatë fazes së regjistrimit, ndjekjes së studimeve, diplomimit dhe akoma më tej pas diplomimit.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Në institucion është ngritur dhe funksionon një sistem i posaçëm për mirëpritjen, informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe ndihmesën e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për mirëpritjen, informimin, këshillimin dhe ndjekjen e përparimit të studentëve.</p> <p>Një informacion i gjerë është i jepet paraprakisht, që nga faza e interesimit për ofertën akademike, si online në web apo rrjete sociale dhe nëpërmjet Zyrës së Pranimit apo Zyrës së Këshillimit Karrieres dhe Kujdesit ndaj Studentit të cilat janë</p>

	<p>dhe përgjegjës për organizimin dhe të një sërë aktiviteteve si ture informuese nëpër gjimnaze, <i>open days</i> në universitet, leksione të hapura, tavolina të rumbulakëta, "Javet e Regjistrimit", etj., ku grupe pedagogesh apo stafi administrativ shperndajnë të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me programet e studimit. Zyra e Pranimit/Regjistrimit kujdesen më tej me asistencën dhe ndjekjen e të gjitha aspekteve për regjistrimi e studentëve.</p> <p>Këshillimi, ndjekja e përparimit të studentëve dhe ndihma ndaj tyre realizohet falë një sërë mekanizmash/ figurash/zyrash mbështetëse si këshilluesit akademik, sekretaria mësimore, koordinatorët e departamenteve/programëve, Zyra e Këshillimit Karrieres dhe Kujdesit ndaj Studentit. Ndjekja ka të bëjë për çeshtje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit, probleme, këshillime, qeverisjen studentore, klubet studentore, shkolla stinore, trajnime, zhvillim praktikash profesionale, lidhje me tregun gjatë/mbas përfundimit të studimeve, etj. Një pasqyrë e plotë e punës së këtyre zyrave, e shpjeguar dha gjatë takimit monitories jepet te "E.VII. Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit" e vënë të dispozicion me RVB.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Përmes zyrës/njesisë për këshillimin e karrierës, institucioni mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm lidhur me plotësimin e detyrimeve të procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe e Kujdesit ndaj Studentit (Ref. Nr. 12 e DVB) është aktive në çdo kohë dhe përkujdeset për mirëpritjen e çdo problem që mund të kenë studentët si dhe me ndarjen në mënyrë periodike të informacioneve të nevojshme për mbarëvajtjen e studimeve apo mundësi që mund të krijohen për studentët, qofshin në nivel shkëmbimesh potenciale, zhvillim praktikash apo informacione nga tregu i punës.</p> <p>Zyra asiston gjithashtu në krijimin e kontakteve/marrëveshjeve me kompani, organizata apo institucione në funksion të zhvillimit të praktikave profesionale dhe informon departamentet përkatvse dhe studentët për këto mundësi.</p> <p>Gjithashtu pjesë e rëndësishme e aktivitetit të zyrës është dhe asistenca dhe përgatitja e studentëve për tregun e punës me anë të organizimit të <i>open days</i> dhe panireve të punës, duke shpërndarë informacion për vende potenciale por dhe duke i trajnuar studentët për përgatitje Letrash motivimi, mënyrat e korrespondencës me zyrat e burimeve njerëzore të kompanive ku aplikohet, në hartimin e CV-ve, trajnime për intervista pune, <i>Mentorim &amp; Networking</i>, etj.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit, ua vë ato në dispozicion studentëve</p>	<p>Nëpërmjet kontaktit periodik me të diplomuarit, Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Shoqata Alumni, gjeneron dhe informacione në lidhje me punësimin e të diplomuarve. Këto statistika, si sasore dhe cilësore (pra duke parë nëse punësimi është brenda profilit) janë të disponueshme për vlerësim në</p>

dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse dhe merr masa për përmirësimin e shkallës dhe cilësisë së punësimit të tyre.	mënyrë që të merren masa për përmirësimet potenciale të programit në mënyrë që të stimulohet një përgatitje më e mirë për tregun e punës (Tabela 23 e Ref. Nr. 29).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit me karakter profesional “Dizajn i Aplikuar dhe Modë” të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti European i Tiranës”**

**Pikat e forta dhe afirmime**

1. Programi i studimit me karakter profesional në “Dizajn i Aplikuar dhe Modë” është i hartuar në përputhje me strategjinë e zhvillimit/zgjerimit të ofertës akademike të institucionit dhe adreson nevojat e tregut të punës duke qënë i hartuar në përputhje me nivelin e studimit, me objektiva formimi të qarta dhe në sintoni me politikat kombëtare për zhvillimin e arsimit profesional.
2. Kërkesa në rritje për këtë lloj profesioni, vecantërisht në vend dhe rajon për shkak dhe të tipologjive të aktiviteteve ekonomike në lidhje me programin, krijon mundësi të mira për punësimin e të diplomuarve si dhe në nivel *macro* mund të sjell përfitime dhe për kompanitë lokale të fokusuara në këtë fushë.
3. UET ka një sistem të mirë organizuar dhe funksional të sigurimit të brendshëm të cilësisë në disa nivele duke mundësuar një monitorim dhe përmirësim të vazhdueshëm të programit të studimit.
4. Për këtë fazë dhe përmbajtje të programit, institucioni ofron laboratore dhe ambiente mësimi dhe studimi të bollshme në shërbim të tij.
5. Staf i akademik i rekrutuar për këtë program ka në përbërje të tij personazhe shumë të kualifikuar dhe me përvojë të gjerë në mësimdhënie dhe në praktikën profesionale në fushat përkatëse. Ky është një faktor i rëndësishëm si në “marketimin” e programit ashtu dhe në mesimdhënie apo formimin e studentëve.


6. Numri jo shumë i lartë i studentëve dhe sasia e lartë e praktikave mësimore për shkak të karakterit të programit garanton një marrëdhënie dhe komunikim intensiv dhe të ngushtë pedagog-student.
7. UET, me ndihmën e zyrave përkatëse, ka ngritur një rrjet të formalizuar partnerësh nga tregu i punës për të mundësuar zhvillimin e praktikave profesionale të studentëve. Njëherazi ky rrjet mund të shërbej dhe si burim informacioni për përmirësimin e kurrikulës, organizimin e aktiviteteteve apo integrimin e studentëve në tregun e punës.
8. Përfshirja e programit brenda Departamentit të Arteve të Aplikuara ndikon pozitivisht në një ndërveprim me profilet dhe disiplinat e tjera artistike, kjo dhe falë një numëri të madh aktivitetesh kurrikularë dhe ekstra kurrikularë ku bëhet i mundur përfshirja, ndërveprimi dhe promovimi i studentëve. Pavarësisht se nuk duhet gjykuar si detyrim, një aspekt pozitiv është dhe mundësia për ato studentë që duan të vijojnë karrierën akademike në BA në Arte Pamore duke ofruar një specializime dhe thellim të mëtejshëm.

#### **Pika të dobta/rreziqe**

1. Pavarësisht se shikohet një rritje e nivelit të notave mesatare në hyrje të studentëve nga viti në vit, vërehet një ulje e numrit të studentëve të regjistruar në vetëm një në vitin e fundit. Kjo mund të jetë e ndikuar nga kushte të diktuar nga pandemia që pamundëson marketimin/ interesin, gjithsesi përbën një rrezik për qendrueshmërinë e programit. Rënia demografike në nivel kombëtar si dhe rënia e numrit të aplikantëve në IAL në Shqipëri në tërësi, mund të prekë edhe numrin e të regjistruarve në këtë program studimi.
2. Nëse nga njëra anë prania brenda Departamentit të BA në Arte Pamore (me profile Dizajn Grafik dhe Multimedia) përbën një mundësi për një ndërveprim më të mirë në lidhje me burimet njerëzore dhe materiale, nga ana tjetër mund të përbëjë një risk për nënvlerësimin e programit me karakter profesional, vecantërisht heqja e mesatares hyrëse në BSc/BA mund të shkaktojë probleme në regjistrimet e studentëve pasi kjo mund të ndikojë në përzgjedhjen e atyre programeve në krahasim me programet me karakter profesional.
3. Ekzistenca tashmë e disa programeve në fushën e dizajnit si brenda institucionit në cikle dhe specializime të ndryshme ashtu dhe në institucione të tjera dhe mungesa në përgjithësi e stafit akademik në fushën e dizajnit bërëbën një rrezik që mund të reflektohet si në rekrutimet e studentëve ashtu dhe të stafit duke ndikuar potencialisht në mungesë të tyre apo dhe në rritjen e ngarkesës së stafit aktual.
4. Institucion ka një sërë marrëveshjesh në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar (përtej atyre për zhvillimin e praktikave profesionale) por vërehet që përgjithësisht nuk janë aktive në nivel të Programi të studimit me karakter profesional në “Dizajn i Aplikua dhe Modë” duke ndikuar në një përfshirje të ulët të “programit” (stafit apo studentëve) në projektet e ndryshme kërkimore/zhvillimore/shkembimi në bashkëpunim me institucione kombëtare dhe ndërkombëtare.
5. Mungesa e literaturës bashkëkohore në gjuhën shqipe në fushën e Dizajnit.

## Rekomandime

1. Institucioni ka dhe strukturat e duhura dhe marreveshjet bashkëpunimit për zhvillimin e praktikave profesionale, gjithsesi gjykohet që duhet nxitur lidhja e mëtejshme e bashkëpunimeve me kompani të tjera të lidhura ngushtë me profilin e programit dhe të nxitet kryerja e praktikave profesionale në këto kompani. Kjo jo vetëm do nxiste marrjen e inputeve për përmirësimin e programin dhe aftësimin e studentëve por do nxiste dhe punësimin e të diplomuarve në këto partnerë. Një performance/garanci e mirë e punësimit në kompani partnere mund të nxisë interesin e aplikantëve për të përzgjedhur të vazhdojnë studimet në këtë program studimi.
2. Duke njohur veshtirësitë objektive për gjetjen e stafit akademik në profilet specifike të dizajnit në përgjithësi e në modë në vecanti, gjykohet gjithsesi e rëndësishme dhe e domosdoshme vijimi i rekrutimit të stafit të specializuar si dhe ku e mundur nxitja dhe mbështetja e stafit aktual, vecanërisht të ri, për fitimin e kualifikimeve të mëtejshme. Për më tepër rekrutimi i stafit (nuk i referohemi shtimit në numër se ai është i mjaftueshëm) do të garantonte dhe një ngarkesë më optimale për stafin akademik të angazhuar në program.
3. Institucioni ka vënë në dispozicion një sërë titujsh të literaturës përmes bibliotekës së institucionit apo bibliotekave online, gjithsesi nevojat specifike të programit të studimit dhe evolimi i vazhdueshëm i natyrës së këtij profesioni kërkon përditësimin e vazhdueshëm të kapaciteteve duke përditësuar vazhdimisht jo vetëm arkivën e bibliotekës, por edhe duke u abonuar në periodikë të fushave specifike të dizajnit dhe të modës.
4. Institucioni vë në dispozicion një sërë laboratoresh për zhvillimin e mësimdhënies dhe praktikës mësimore. Pavarësisht mjaftueshmërisë së tyre për zhvillimin e programit, rekomandohet që të vijojë pasurimi i tyre për t garantuar një përditësim sa më të mirë të tyre. Kjo mund të arrihet si me pasurimin e *softëare*-ve specifik por dhe me pajisje për *atelier*-at si *presa/stampa për grafikën e shtypur*, pajisje për printime 3D, etj. Gjithashtu rekomandohet që laboratorët e lëndëve praktike-artistike të jenë me kushte më të duhura e sipas kriteve të një laboratorit artistik.
5. Në rastet e tishikimit të kurrikulës të merret parasysh një raport të balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike (50:50) ku rreth 25% e programit i dedikohet aftësimin në praktikë/punë konkrete në profesion. Gjithashtu rekomandohet në specifikimin e temave të syllabuseve, të cilat të jenë më pranë dizajnit dhe modës. Kjo do të shërbente në analizën më të mirë të nevojave të punës, në kuptimin e marrëdhënies konsumator-profesionist, dhe analizën më të detajuar për të kuptuar fenomene shoqërore, ekonomike, politike, kulturore që lidhen ngushtësisht me fushën e dizajnit dhe veçanërisht atë të modës.
6. Pavarësisht ciklit të programit të studimit, gjykohet si e rëndësishme nxitja, mbështetja dhe ndërgjegjësimi i stafit akademik për publikimin e artikujve apo monografive. Kjo do sillte një rritje të kualifikimit të stafit akademik, të nivelit të mësimdhënies si dhe një kontribut me vlerë në rritjen e teorisë/literaturës në këtë fushë në gjuhën shqipe.



## Conclusions of the Evaluation of the study program with professional character "Applied and Fashion Design" of the Institution of Higher Education "European University of Tirana"

### **Strengths and affirmations**

1. The study program with a professional approach in "Applied and Fashion Design" is designed in accordance with the development strategy of the academic offer of the University. It addresses the needs of the labor market designed in accordance with the objectives and national policies for the development of education.
2. There is a growing demand for this profession, especially in the country and region, due to the typologies of economic activities related to the program. It creates good opportunities for employment of the graduates and at the macro level can bring benefits to local companies.
3. UET has a well-organized and functional system of internal quality assurance at several levels enabling a continuous monitoring and improvement of the study program.
4. For this phase and content of the program, the institution offers laboratories and abundant teaching and study facilities.
5. The recruited academic staff for this program has in its composition highly qualified professionals with extensive experience in teaching and professional practice in relevant fields. This is an important factor both in the "marketing" of the program and in the teaching or training of students.
6. The low number of students and the high amount of teaching practices due to the character of the program guarantees an intensive and close teacher-student relationship and communication.
7. UET, with the help of relevant offices, has set up a formalized network of partners from the labor market to enable the development of professional practices of students. At the same time, this network can serve as a source of information for improving the curriculum, organizing activities or integrating students in the labor market.
8. The inclusion of the program within the Department of Applied Arts positively affects an interaction with profiles and other artistic disciplines, thanks to a large number of curricular and extra-curricular activities where it is possible to involve, interact and promote students. Although it should not be judged as an obligation, a positive aspect is the opportunity for those students who want to pursue an academic career in BA in Visual Arts by offering a specialization and further deepening.

### **Weaknesses / risks**

1. Although there is an increase in the level of average grades at the entrance of students from year to year, there is a decrease in the number of students enrolled in the last




year. This can be influenced by pandemic-dictated conditions that make marketing / interest impossible, that poses a risk to the sustainability of the program. The demographic decline at the national level as well as the decline in the number of applicants in Albanian universities in general, may also affect the number of enrollees in this study program.

2. If on the one hand the presence within the BA Department of Visual Arts (with Graphic Design and Multimedia profiles) constitutes an opportunity for a better interaction in terms of human and material resources, on the other hand it may pose a risk of underestimating program of a professional approach. Especially the BSc/BA program can cause problems in student enrollment as this may affect the selection of those programs compared to programs of a professional nature.
3. The already existence of some programs in the field of design both within the institution in different cycles and specializations as well as in other institutions and the general lack of academic staff in the field of design poses a risk that can be reflected in both student recruitment and staff. Thus, potentially affecting their absence or and increasing the workload of current staff.
4. The institution has a number of agreements at the national and international level (beyond those for the development of professional practices), but it is noticed that they are generally not active in the Study Program of "Applied and Fashion Design". This can impact on the inclusion low number of staff or students in various research/development/exchange projects in cooperation with national and international institutions.
5. Lack of contemporary literature in the Albanian language in the field of Applied Design.


### **Recommendation**

1. The institution has the appropriate structures and cooperation agreements for the development of professional practices. However, it is considered that further cooperation should be promoted with other companies closely related to the program profile and to encourage the performance of professional practices in these companies. This would not only encourage inputs to improve the curriculum and training of students but would also encourage the employment of graduates in these partners. A good performance / employment guarantee in partner companies can stimulate the interest of applicants to choose to continue their studies in this study program.
2. Recognizing the objective difficulties in finding academic staff in specific design profiles in general and in particular in particular, it is considered important and necessary to continue the recruitment of specialized staff. And also to encourage and support current staff, especially young ones, for gaining further qualifications. Furthermore the recruitment of staff (we do not refer to the increase in number that it is sufficient) would guarantee a more optimal workload for the academic staff engaged in the program.





3. The institution has made available a number of titles of literature through the institution's library or through online libraries. However the specific needs of the study program and the continuous evolution of the nature of this profession requires constant updating of capacities by updating not only the library archive, but also by subscribing to periodicals of specific fields of design and fashion.
4. The institution should make available a number of laboratories for the development of teaching and teaching practice. Despite their sufficiency for the development of the program, it is recommended that their enrichment continue to guarantee the best possible update. This can be achieved both with the enrichment of specific software, but also with equipment for workshops such as presses/ prints for chalcography, equipment for 3D printing, etc. It is also recommended that the laboratories of practical-artistic subjects to be with more appropriate conditions and according to the criteria of an artistic laboratory.
5. In cases of curriculum review, should be considered a balanced ratio between the modules / activities of theoretical training versus practical ones (50:50) where about 25% of the program is dedicated to training in practice / concrete work in the profession. It is also recommended in specifying themes in syllabus, which are closer to design and fashion. This would serve in the better analysis of work needs, in terms of customer-professional relationship, and a more detailed analysis to understand social, economic, political, cultural phenomena that are closely related to the field of design and especially that of fashion.
6. Regardless of the cycle of the study program, it is considered important to encourage, support and raise the awareness of the academic staff for the publication of articles or monographs in the Albanian language. This would bring an increase in the qualification of the academic staff, the level of teaching as well as a valuable contribution to the growth of theory / literature in this field.

Two blue ink signatures are present at the bottom right of the page. The first signature is a simple, flowing line. The second signature is more complex, with multiple loops and a distinct end stroke.

**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
<b>I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL</b>				<b>X</b>
<b>II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL</b>				<b>X</b>
<b>III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT</b>				<b>X</b>
<b>IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE MBËSHTETJA E STUDENTËVE</b>				<b>X</b>
<b>V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE</b>				<b>X</b>
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				<b>X</b>